

**PHILIPS**

Television

5507 Series

# Manual përdorimi

32PHS5507  
43PFS5507

Register your product and get support at  
[www.philips.com/TVsupport](http://www.philips.com/TVsupport)

# Përmbajtja

<b>1 Merrni mbështetje</b>	<b>3</b>	10.1 Nga një lidhje USB	39
1.1 Identifikimi dhe regjistrimi i televizorit	3	10.2 Fotografitë	39
1.2 Ndhma për televizorin dhe manuali i përdorimit	3	10.3 Video	39
1.3 Ndhma në internet dhe manuali i përdorimit	3	10.4 Muzikë	40
1.4 Kujdesi për klientin / Riparimi	3	<b>11 Hapja e menysë së cilësimeve të televizorit</b>	<b>41</b>
<b>2 Softueri</b>	<b>5</b>	11.1 Pamja e përgjithshme e menysë kryesore	41
2.1 Përditëso softuerin	5	11.2 Menyja e programeve ndihmëse	41
2.2 Versioni i softuerit	5	11.3 "Cilësimet e shpejta" dhe "Të gjitha cilësimet"	41
<b>3 Udhëzuesi i shpejtë</b>	<b>6</b>	11.4 Të gjitha cilësimet	41
3.1 Telekomanda	6	<b>12 Mjedisore</b>	<b>48</b>
3.2 Sensori infrakuq	7	12.1 Etiketa evropiane e energjisë	48
3.3 Leva - komandim lokal (nëse ka)	8	12.2 Fleta e produktit	48
<b>4 Konfigurimi</b>	<b>9</b>	12.3 Numri i regjistrimit i EPREL	49
4.1 Lexoni për sigurinë	9	12.4 Fundi i përdorimit	50
4.2 Vendosja e televizorit	9	12.5 Deklarata e konformitetit për MB	50
4.3 Ndezja e televizorit	12	<b>13 Specifikimet</b>	<b>51</b>
<b>5 Lidhjet</b>	<b>13</b>	13.1 Energjia	51
5.1 Udhëzuesi i lidhjeve	13	13.2 Marrja	51
5.2 Antena (Televizorët e serive 4503, 5503, 4304, 4354, 4504, 5304, 5605-32")	13	13.3 Rezolucioni i ekranit	51
5.3 Antena (Televizorët e serive 5505, 5525, 5535, 5605-24", 5507, 5527, 5537)	13	13.4 Rezolucioni i hyrjes së ekranit	52
5.4 Satelitor (nëse ka)	13	13.5 Zëri	52
5.5 Pajisja e videos	14	13.6 Multimedia	53
5.6 Pajisja e zërit	17	13.7 Lidhja	53
5.7 Kompjuteri	19	<b>14 Zgjidhja e problemeve</b>	<b>56</b>
5.8 Moduli CAM me kartë "Smart" - CI+	20	14.1 Këshilla	56
5.9 Pajisja USB	21	14.2 Aktivizimi	56
5.10 Rrjeti me tela - "Freeview" (foleja e rrjetit ofrohet vetëm për modelet e Mbretërisë së Bashkuar)	22	14.3 Telekomanda	56
<b>6 Ndërrimi i burimit</b>	<b>24</b>	14.4 Kanalet	57
6.1 Lista e burimeve	24	14.5 Figura	57
6.2 Riemërtimi i pajisjes	24	14.6 Zëri	57
<b>7 Kanalet</b>	<b>25</b>	14.7 HDMI	57
7.1 Rreth kanaleve dhe ndërrimit të tyre	25	14.8 USB	58
7.2 Instalimi i kanalit	25	<b>15 Siguria dhe kujdesi</b>	<b>59</b>
7.3 Lista e kanaleve	30	15.1 Siguria	59
7.4 Zgjedhja e filtrit të kanaleve	31	15.2 Kujdesi për ekranin	60
7.5 Kanalet e preferuara	32	15.3 Kushtet e përdorimit	60
<b>8 Guida televizive</b>	<b>34</b>	<b>16 Të drejtat e autorit</b>	<b>62</b>
8.1 Çfarë ju duhet	34	16.1 HDMI	62
8.2 Përdorimi i guidës televizive	34	16.2 HEVC Advance	62
<b>9 Regjistrimi i dhe pushimi i televizorit (nuk vlen për modelet për Turqinë)</b>	<b>36</b>	16.3 Dolby Audio	62
9.1 Çfarë ju duhet	36	16.4 DTS 2.0 + Digital Out™	62
9.2 Regjistrimi	36	16.5 Markat e tjera tregtare	62
9.3 Pushimi i televizorit	37	<b>17 Burim i hapur</b>	<b>63</b>
<b>10 Videot, fotografitë dhe muzika</b>	<b>39</b>	17.1 Softueri me burim të hapur	63
		17.2 Licenca e burimit të hapur	63
		<b>Tregues</b>	<b>66</b>

# Merrni mbështetje

## Identifikimi dhe regjistrimi i televizorit

Identifikoni televizorin - modelin e televizorit dhe numrin e serisë

Mund t'ju kërkohet të jepni numrin e modelit dhe numrin e serisë së televizorit. Këta numra gjenden në etiketën e paketimit ose në etiketën e llojit, e cila ndodhet në pjesën e pasme ose të poshtme të televizorit.

### Regjistrimi i televizorit

Regjistrojeni televizorin dhe shijoni një sërë përfitimesh, duke përfshirë mbështetje të plotë (duke përfshirë ngarkimet), hyrje të privilegjuar në informacionet mbi produktet e reja, uljet e çmimeve dhe ofertat ekskluzive, mundësinë për të fituar çmime, madje dhe për të marrë pjesë në anketime të posaçme për produktet e reja.

Shkoni te [www.philips.com/TVsupport](http://www.philips.com/TVsupport)

## Ndihma për televizorin dhe manuali i përdorimit

Shtypni  Cilësimet > Ndihmë

Në menynë "Ndihmë", mund të përditësoni me lehtësi softuerin, të rivendosni televizorin në cilësimet standarde dhe të lexoni manualin e përdorimit.

- Përditësimi i softuerit: Kontrolloni për përditësimet e mundshme të softuerit.
- Manuali i përdorimit: Lexoni manualin e përdorimit për informacion rreth televizorit.
- Diagnostikimi: Gjeni një zgjidhje për pyetjet që bëhen shpesh.
- Cilësimet e fabrikës: Rivendosni të gjitha cilësimet në vlerat e fabrikës.
- Riinstalimi i televizorit: Kryeni sërish instalimin e plotë të televizorit.
- Informacioni i kontaktit: Shfaqni numrin e telefonit ose adresën e internetit për shtetin ose rajonin ku ndodheni.

## Ndihma në internet dhe manuali i përdorimit

Për të zgjidhur problemet e televizorit Philips, mund t'i drejtoheni ndihmës që ofrojmë në internet. Mund të zgjidhni gjuhën tuaj dhe të jepni numrin e modelit të produktit.

Shkoni te [www.philips.com/TVsupport](http://www.philips.com/TVsupport).

Te faqja mbështetëse në internet mund të gjeni numrin e telefonit të kontaktit me ne për shtetin tuaj, si edhe përgjigjet për pyetjet e shpeshta (FAQ). Në disa shtete mund të bisedoni me një nga bashkëpunëtorët tanë për t'i bërë pyetjet drejtpërdrejt apo për të dërguar një pyetje me email. Softuerin e televizorit apo manualin mund ta shkarkoni për ta lexuar në kompjuter.

Për më tej në lidhje me diagnostikimin e televizorit dhe pyetjet e shpeshta (FAQ)...

Shkoni te <http://philips-tvconsumercare.kxondemand.com/portal/en/ModelSelect>

### "Ndihma e televizorit" në tabletë, celular inteligjent ose kompjuter

Për t'i zbatuar më lehtë sekuencat e zgjeruara të udhëzimeve, "Ndihmën për televizorin" mund ta shkarkoni në format PDF, për ta lexuar në celularin inteligjent, në tabletë ose në kompjuter. Përndryshe mund të printoni faqen përkatëse "Ndihma" nga kompjuteri.

Për të shkarkuar "Ndihmën" (manualin e përdorimit), shkoni te [www.philips.com/TVsupport](http://www.philips.com/TVsupport)

## Kujdesi për klientin / Riparimi

Për mbështetjen dhe riparinin e televizorit, telefononi kujdesin për klientin në vendin tuaj. Teknikët tanë të shërbimit do të kujdesen për riparinin, nëse nevojitet.

Gjeni numrin e telefonit të printuar në dokumentacionin e pajisur me televizorin. Ose konsultohuni me faqen tonë të internetit [www.philips.com/TVsupport](http://www.philips.com/TVsupport) dhe zgjidhni shtetin ku ndodheni nëse nevojitet.

### Numri i modelit dhe numri i serisë i televizorit

Mund t'ju kërkohet të jepni numrin e modelit dhe numrin e serisë së televizorit. Këta numra gjenden në etiketën e paketimit ose në etiketën e llojit, e cila ndodhet në pjesën e pasme ose të poshtme të televizorit.

### Paralajmërim

Mos u përpiqni ta riparoni vetë televizorin. Kjo mund të shkaktojë lëndime të rënda, dëmtime të pariparueshme në televizor ose mund ta bëjë garancinë të pavlefshme.

---

# Softueri

---

## Përditëso softuerin

---

### Kërkimi për përditësime

🏠 (Kryefaqja) > Cilësimet > Përditësimi i softuerit > Kërkimi për përditësime.

Për të ngarkuar softuerin në televizor, ju duhet një kompjuter dhe një pajisje memorieje USB. Përdorni një pajisje memorieje USB me hapësirë të lirë 256 MB. Sigurohuni që mbrojtja ndaj shkrimit të mos jetë aktive.

1. Filloni përditësimin në televizor  
- 🏠 (Kreu) > Cilësimet > Përditëso softuerin > Kërko për përditësime.

2. Identifikimi i televizorit  
- Futni memorien USB në një nga lidhjet e USB në televizor.

Zgjidhni **Nisje** dhe shtypni **OK**. Te pajisja e memories USB do të shkruhet një skedar identifikimi.

3. Shkarkoni softuerin e televizorit  
- Futni memorien USB në kompjuter.  
- Te pajisja e memories USB, gjeni skedarin **update.htm** dhe dyklikojeni.  
- Klikoni **Dërgo ID**.  
- Zgjidhni rajonin tuaj  
- Nëse ka softuer të ri, shkarkoni skedarin .zip.

Pas shkarkimit, dekompresojeni skedarin dhe kopjoni skedarin **autorun.upg** te pajisja e memories USB.

4. Përditësimi i softuerit të televizorit  
- Futeni sërish në televizor memorien USB. Përditësimi do të fillojë automatikisht. Televizori fiket vetë për 10 sekonda dhe rindizet automatikisht. Prisni.

Mos . . .

- e hiqni pajisjen e memories USB nga televizori

Nëse gjatë përditësimit ndërpritet energjia elektrike, pajisjen e memories USB mos e hiqni asnjëherë nga televizori. Përditësimi do të vazhdojë kur të rikthehet energjia.

---

## Përditësimet lokale

Për shitësit dhe përdoruesit ekspertë...

🏠 (Kryefaqja) > Cilësimet > Përditësimi i softuerit > Përditësimet lokale.

---

## Kërkimi për përditësime OAD (shkarkim me valë)

Kërkoni për përditësimin me valë të softuerit.

🏠 (Kryefaqja) > Cilësimet > Përditësimi i softuerit > Kërkimi për përditësime OAD.

\* Ofrimi i përditësimeve OAD varet nga shteti ku ndodheni.

## Versioni i softuerit

Për të parë versionin aktual të softuerit të televizorit...

🏠 (Kryefaqja) > Cilësimet > Përditësimi i softuerit > Të dhënat e softuerit aktual

# Udhëzuesi i shpejtë

## Telekomanda

### Bateritë dhe pastrimi

#### Ndërrimi i baterive

Nëse televizori nuk reagon ndaj shtypjes së tasteve të telekomandës, kësaj mund t'i kenë rënë bateritë.

Për të ndërruar bateritë, hapni folenë e baterive në anën e pasme të telekomandës.

1. Rrëshqitni kapakun e folesë së baterive në drejtimin që tregohet me shigjetë.

2. Ndërroni bateritë e vjetra me 2 bateri të llojit AAA-R03-1,5 V. Sigurohuni që polet + dhe - të baterive të vendosen siç duhet.



3. Rivendosni kapakun e folesë së baterive dhe rrëshqiteni në vend derisa të puthitet.

- Hiqini bateritë nëse nuk do ta përdorni telekomandën për kohë të gjatë.

- Hidhni bateritë e vjetra sipas udhëzimeve të përfundimit të përdorimit.

#### Pastrimi

Telekomanda është e veshur me një shtresë rezistente ndaj gërvishjeve.

Për ta pastruar telekomandën, përdorni një leckë të butë e të lagur. Mos përdorni asnjëherë mbi telekomandë substanca si alkooli, kimikatet ose solucionet pastruese për shtëpinë.

## Përmbledhje e tasteve

### Pjesa e sipërme



#### 1. Pritje / Ndezur

Për të ndezur televizorin ose për ta kaluar në gjendje pritjeje.

#### 2. Tastet e luajtjes

- Play ►, për të luajtur
- Pause ||, për të ndaluar luajtjen
- Stop ■, për të ndërprerë luajtjen
- Rewind ◀◀, për të ecur mbrapsht
- Fast forward ▶▶, për të ecur shpejt përpara
- Record ●, për të regjistruar në çast

\* Modelet për Turqinë nuk mbështetin regjistrimin dhe pushimin në pauzë të televizorit.

#### 3. TV GUIDE

Për të hapur ose mbyllur funksionin Guida televizive.


#### 4. FORMAT

Për të hapur ose mbyllur menynë "Formati i figurës".

#### 5. SETUP

Për të hapur menynë "Cilësimet".

### Lart (për modelet për Turqinë)



#### 1. Pritje / Ndezur

Për të ndezur televizorin ose për ta kaluar në gjendje pritjeje.

#### 2. Tastet e luajtjes

- Luaj ►, për të nisur luajtjen
- Pushim ||, për të pushuar luajtjen
- Ndalo ■, për të ndaluar luajtjen
- Kthim pas ◀◀, për ta kthyer pas
- Shpejt përpara ▶▶, për të ecur shpejt përpara

#### 3. TV GUIDE

Për të hapur ose mbyllur funksionin Guida televizive.

#### 4. Shfletuesi i medias

Për të hapur ose për të mbyllur menynë Shfletuesi i medias.


#### 5. FORMAT

Për të hapur ose mbyllur menynë "Formati i figurës".

#### 6. SETUP

Për të hapur menynë "Cilësimet".

### Mesatar



#### 1. HOME

Për të hapur ose mbyllur menynë kryesore.

#### 2. SOURCES

Për të hapur menynë "Burimet" - listën e pajisjeve të lidhura.

#### 3. Colour keys

Funksionet e butonave ndjekin udhëzimet në ekran.

#### 4. INFO

Për të hapur ose mbyllur informacionin e programit.

#### 5. BACK

Për të kaluar sërish te kanali i mëparshëm që kishit zgjedhur.

Për të mbyllur një meny pa ndryshuar cilësimet.

#### 6. EXIT

Për t'u kthyer te shikimi i televizorit.

#### 7. OPTIONS

Për të hapur ose mbyllur menynë "Opsionet".

#### 8. Tasti OK

Për të konfirmuar zgjedhjen ose cilësimin.

#### 9. Tastet me shigjeta/të shfletimit

Për të lëvizur lart, poshtë, majtas ose djathtas.

#### 10. LIST

Për të hapur ose mbyllur listën e kanaleve.

### Nga poshtë



#### 1. Mute

Për të hequr zërin ose për ta rikthyer.

#### 2. Volume

Për të rregulluar nivelin e volumit.

#### 3. Tastet numerike

Për të zgjedhur direkt një kanal televiziv.

#### 4. SUBTITLE

Për të caktuar titrat në "Aktive", "Joaktive" ose "Automatike".

#### 5. Channel

Për të kaluar te kanali vijues ose i mëparshëm në listën e kanaleve. Për të hapur faqen vijuese ose të mëparshme tek "Teleteksti". Për të hapur kapitullin vijues ose të mëparshëm në një disk.

#### 6. TEXT

Për të hapur ose mbyllur funksionin "Teleteksti".

### 3.2

## Sensori infrakuq

Televizori mund të marrë komanda edhe nga një telekomandë që përdor IR (rreze infrakuqe) për të dërguar komanda. Nëse përdorni telekomandë të tillë, sigurohuni gjithmonë që ta drejtoni telekomandën nga sensorin infrakuq në pjesën e përparme të televizorit.



#### Paralajmërim

Mos vendosni objekte para sensorit infrakuq të

televizorit pasi mund të bllokojë sinjalin.


3.3

## Leva - komandim lokal (nëse ka)




### Leva - Komandim lokal


Nëse ju ka humbur telekomanda ose i kanë rënë bateritë, mund të kryeni gjithsesi disa veprime bazë në televizor.

Për të hapur menynë bazë...



1. Me televizorin ndezur, shtypni tastin e levës në pjesën e pasme ose në pjesën e poshtme të televizorit për të shfaqur menynë bazë.

2. Shtypni majtas ose djathtas për të zgjedhur  "Volumin",  "Kanalin" ose  "Burimet".



Shtypni lart ose poshtë për të rregulluar volumin ose për t'u sintonizuar në kanal in vijues ose atë të mëparshëm. Shtypni lart ose poshtë për të kaluar nëpër listën e burimeve, duke përfshirë zgjedhjen e sintonizuesit.

Menyja do të zhduket automatikisht.



# Konfigurimi

## 4.1

### Lexoni për sigurinë

Lexoni udhëzimet e sigurisë përpara se të përdorni televizorin.

Për të lexuar udhëzimet, shikoni kapitullin Siguria dhe kujdesi të Manuali i përdorimit.

## 4.2

### Vendosja e televizorit

#### Këshilla mbi vendosjen

- Pozicionojeni televizorin në vende ku drita nuk bie drejtpërdrejt në ekran.
- Pozicionojeni televizorin deri në 15 cm larg murit.
- Distanca ideale për të parë televizor është 3 herë sa gjatësia diagonale e ekranit. Kur jeni të ulur, sytë duhet të jenë në një nivel me mesin e ekranit.



Shënim:

Mbajeni televizorin larg burimeve që prodhojnë pluhur, si p.sh. sobat. Sugjerohet t'i pastroni rregullisht pluhurat për të shmangur futjen e tij në televizor.

#### Bazamenti i televizorit


Udhëzimet për montimin e bazamentit të televizorit mund t'i gjeni në udhëzuesin e shpejtë që vjen me televizorin. Në rast se ju ka humbur ky udhëzues, mund ta shkarkoni nga [www.philips.com](http://www.philips.com).

Përdorni numrin e modelit të televizorit për të kërkuar e shkarkuar Udhëzuesin e shpejtë.

## Montimi në mur

Televizorët e serive 4304, 4354

Televizori juaj është i përgatitur gjithashtu për suport muri të standardit VESA (shitet veçmas). Përdorni kodin e mëposhtëm VESA gjatë blerjes së suportit të murit. . .



- 24PHx43x4 - VESA MIS-F 75x75, M4 (minimumi 10 mm, maksimumi 12 mm)

#### Përgatitja


Sigurohuni që vidat metalike për montimin e televizorit me suport të standardit VESA të futen rreth 10 mm në bokullat e filetuara të televizorit.

#### Kujdes

Montimi i televizorit në mur kërkon ekspertizë dhe duhet të kryhet vetëm nga personeli i kualifikuar. Montimi i televizorit në mur duhet të përmbushë standardet e sigurisë sipas peshës së televizorit. Gjithashtu, lexoni masat paraprake të sigurisë para pozicionimit të televizorit. "TP Vision Europe B.V." nuk mban përgjegjësi për montimin e pasaktë apo montime të tjera që mund të shkaktojnë aksident ose lëndim.

Televizorët e serive 4504, 4503

Televizori juaj është i përgatitur gjithashtu për suport muri të standardit VESA (shitet veçmas). Përdorni kodin e mëposhtëm VESA gjatë blerjes së suportit të murit. . .



- 32PHx450x - VESA MIS-F 100, M6 (minimumi 12 mm, maksimumi 16 mm)

#### Përgatitja

Sigurohuni që vidat metalike për montimin e televizorit me suport të standardit VESA të futen rreth 10 mm në bokullat e filetuara të televizorit.

#### Kujdes

Montimi i televizorit në mur kërkon ekspertizë dhe duhet të kryhet vetëm nga personeli i kualifikuar.

Montimi i televizorit në mur duhet të përmbushë standardet e sigurisë sipas peshës së televizorit.

Gjithashtu, lexoni masat paraprake të sigurisë para pozicionimit të televizorit.


"TP Vision Europe B.V." nuk mban përgjegjësi për montimin e pasaktë apo montime të tjera që mund të shkaktojnë aksident ose lëndim.

---

#### Televizorët e serisë 5304

Televizori juaj është i përgatitur gjithashtu për suport muri të standardit VESA (shitet veçmas).

Përdorni kodin e mëposhtëm VESA gjatë blerjes së suportit të murit. . .



- 22PFS5304 - VESA MIS-F 75x75, M4 (minimumi 8 mm, maksimumi 8 mm)

#### Përgatitja

Sigurohuni që vidat metalike për montimin e televizorit me suport të standardit VESA të futen rreth 10 mm në bokullat e filetuara të televizorit.

#### Kujdes

Montimi i televizorit në mur kërkon ekspertizë dhe duhet të kryhet vetëm nga personeli i kualifikuar.

Montimi i televizorit në mur duhet të përmbushë standardet e sigurisë sipas peshës së televizorit.

Gjithashtu, lexoni masat paraprake të sigurisë para pozicionimit të televizorit.


"TP Vision Europe B.V." nuk mban përgjegjësi për montimin e pasaktë apo montime të tjera që mund të shkaktojnë aksident ose lëndim.

---

#### Televizorët e serisë 5503

Televizori juaj është i përgatitur gjithashtu për suport muri të standardit VESA (shitet veçmas).

Përdorni kodin e mëposhtëm VESA gjatë blerjes së suportit të murit. . .



- 43PFx5503 - VESA MIS-F 200x100, M6 (minimumi 9 mm, maksimumi 11 mm)

#### Përgatitja

Sigurohuni që vidat metalike për montimin e televizorit me suport të standardit VESA të futen rreth 10 mm në bokullat e filetuara të televizorit.

#### Kujdes

Montimi i televizorit në mur kërkon ekspertizë dhe duhet të kryhet vetëm nga personeli i kualifikuar.

Montimi i televizorit në mur duhet të përmbushë standardet e sigurisë sipas peshës së televizorit.

Gjithashtu, lexoni masat paraprake të sigurisë para pozicionimit të televizorit.


"TP Vision Europe B.V." nuk mban përgjegjësi për montimin e pasaktë apo montime të tjera që mund të shkaktojnë aksident ose lëndim.

---

#### Televizorët e serive 5505, 5525, 5535

Televizori juaj është i përgatitur gjithashtu për suport muri të standardit VESA (shitet veçmas).

Përdorni kodin e mëposhtëm VESA gjatë blerjes së suportit të murit. . .



- 24PFx55x5 - VESA MIS-F 75x75, M4 (minimumi 8 mm, maksimumi 10 mm)

- 32PHx55x5 - VESA MIS-F 100, M6 (minimumi 12 mm, maksimumi 16 mm)


- 43PFx55x5 - VESA MIS-F 200x100, M6 (minimumi 8 mm, maksimumi 10 mm)

#### Përgatitja

Sigurohuni që vidat metalike për montimin e televizorit me suport të standardit VESA të futen rreth 10 mm në bokullat e filetuara të televizorit.

#### Shënim

Për modelin 24 inç, sigurohuni që pllaka më e madhe e montimit ose suporti më i madh nuk ndërhyjnë te bashkuesi elektrik.



### Kujdes


Montimi i televizorit në mur kërkon ekspertizë dhe duhet të kryhet vetëm nga personeli i kualifikuar. Montimi i televizorit në mur duhet të përmbushë standardet e sigurisë sipas peshës së televizorit. Gjithashtu, lexoni masat paraprake të sigurisë para pozicionimit të televizorit.

"TP Vision Europe B.V." nuk mban përgjegjësi për montimin e pasaktë apo montime të tjera që mund të shkaktojnë aksident ose lëndim.

---

### Televizorët e serisë 5605

Televizori juaj është i përgatitur gjithashtu për suport muri të standardit VESA (shitet veçmas). Përdorni kodin e mëposhtëm VESA gjatë blerjes së suportit të murit. . .




- 24PFS5605 - VESA MIS-F 75x75, M4 (minimumi 8 mm, maksimumi 10 mm)
- 32PFS5605 - VESA MIS-F 100x100, M4 (minimumi 10 mm, maksimumi 14 mm)

### Përgatitja

Sigurohuni që vidat metalike për montimin e televizorit me suport të standardit VESA të futen rreth 10 mm në bokullat e filetuara të televizorit.

### Shënim

Për modelin 24 inç, sigurohuni që pllaka më e madhe e montimit ose suporti më i madh nuk ndërhyjnë te bashkuesi elektrik.



### Kujdes


Montimi i televizorit në mur kërkon ekspertizë dhe duhet të kryhet vetëm nga personeli i kualifikuar. Montimi i televizorit në mur duhet të përmbushë standardet e sigurisë sipas peshës së televizorit. Gjithashtu, lexoni masat paraprake të sigurisë para pozicionimit të televizorit.

"TP Vision Europe B.V." nuk mban përgjegjësi për montimin e pasaktë apo montime të tjera që mund të shkaktojnë aksident ose lëndim.

---

### Televizorët e serive 5507, 5527, 5537

Televizori juaj është i përgatitur gjithashtu për suport muri të standardit VESA (shitet veçmas). Përdorni kodin e mëposhtëm VESA gjatë blerjes së suportit të murit. . .




- 24PHS55x7 - VESA MIS-F 75x75, M4 (minimumi 8 mm, maksimumi 10 mm)
- 32PHS55x7 - VESA MIS-F 100x100, M4 (minimumi 8 mm, maksimumi 10 mm)
- 43PFS5507 - VESA MIS-F 100x200, M6 (minimumi 8 mm, maksimumi 11 mm)

### Përgatitja

Sigurohuni që vidat metalike për montimin e televizorit me suport të standardit VESA të futen rreth 10 mm në bokullat e filetuara të televizorit.

### Shënim

Për modelin 24 inç, sigurohuni që pllaka më e madhe e montimit ose suporti më i madh nuk ndërhyjnë te bashkuesi elektrik.



### Kujdes

Montimi i televizorit në mur kërkon ekspertizë dhe duhet të kryhet vetëm nga personeli i kualifikuar. Montimi i televizorit në mur duhet të përmbushë standardet e sigurisë sipas peshës së televizorit. Gjithashtu, lexoni masat paraprake të sigurisë para pozicionimit të televizorit.

"TP Vision Europe B.V." nuk mban përgjegjësi për montimin e pasaktë apo montime të tjera që mund të shkaktojnë aksident ose lëndim.


### 4.3

## Ndezja e televizorit


### Lidhja e kordonit elektrik

- Futni kordonin elektrik te foleja **POWER** mbrapa televizorit.
- Sigurohuni që kordoni elektrik është lidhur në mënyrë të sigurt në fole.
- Sigurohuni që të mund ta arrini gjithmonë spinën në prizë.
- Kur e hiqni nga priza kordonin, tërhiqni gjithmonë spinën dhe asnjëherë kordonin.


Për 32" e lart



Për 22"/24"



Për 24PFS5535/24PHS5537



Edhe pse televizori ka konsum shumë të ulët energjie gjatë qëndrimit në pritje, hiqeni nga priza për të kursyer energji nëse nuk e përdorni për kohë të gjata.

### Ndezja ose kalimi në gjendje pritjeje

Përpara se të ndizni televizorin, sigurohuni që të lidhni rrjetin elektrik në folenë **POWER** në pjesën e pasme të televizorit.

#### Aktivizimi

Shtypni butonin e ndezjes (nëse ka) në pjesën anësore ose të pasme të televizorit. Ose shtypni **⏻** në telekomandë.

#### Kalimi në modalitet pritjeje

Për ta kaluar televizorin në pritje, shtypni **⏻** në telekomandë.

Për ta fikur plotësisht televizorin, shkëputni spinën. Gjatë shkëputjes së prizës, tërhiqni gjithmonë spinën dhe asnjëherë kordonin. Sigurohuni që të mund ta arrini gjithmonë spinën, kordonin elektrik dhe prizën.

# Lidhjet

## 5.1

### Udhëzuesi i lidhjeve

Gjithmonë lidhni pajisjen me televizorin me lidhjen më cilësore të mundshme. Gjithashtu, përdorni kablllo të cilësisë së lartë për të garantuar transferim të mirë të figurës dhe zërit.

Kur lidhni një pajisje, televizori e njeh llojin e saj dhe i jep secilës pajisje emrin e saktë të llojit. Mund ta ndryshoni emrin e llojit nëse dëshironi. Nëse pajisjes i caktohet emri i duhur i llojit, televizori kalon automatikisht në cilësimet e tij ideale kur kaloni te kjo pajisje në menynë "Burimet".

## 5.2


### Antena (Televizorët e serive 4503, 5503, 4304, 4354, 4504, 5304, 5605-32")

Futni mirë fishën e antenës në folenë Antena në pjesën e pasme të televizorit.


Mund të lidhni antenën tuaj ose sinjalin e antenës nga një sistem shpërndarjeje të sinjalit të antenës. Përdorni fole antene RF IEC për koaksial 75 om.

Përdoreni këtë lidhje antene për sinjale hyrëse DVB-T dhe DVB-C.

Për 32" e lart



Për 22"/24"



\* Foleja e rrjetit është vetëm për modelet në Mbretërinë e Bashkuar

\*\* Foleja e satelitit është vetëm për serinë xxPxSxxxx


## 5.3

### Antena (Televizorët e serive 5505, 5525, 5535, 5605-24", 5507, 5527, 5537)

Futni mirë fishën e antenës në folenë Antena në pjesën e pasme të televizorit.

Mund të lidhni antenën tuaj ose sinjalin e antenës nga një sistem shpërndarjeje të sinjalit të antenës. Përdorni fole antene RF IEC për koaksial 75 om.


Përdoreni këtë lidhje antene për sinjale hyrëse DVB-T dhe DVB-C.




## Satelitor (nëse ka)

Lidhni fishën satelitore tip "F" me folenë satelitore SAT në pjesën e pasme të televizorit.


Për 32" ose më lart (seritë 4503, 4504, 5503, 5605-32")




Për 22"/24" (seritë 4304, 4354, 5304)



Për 32" ose më lart (seritë 5505, 5525, 5507, 5527, 5537)



Për 24" (seritë 5505, 5525, 5535, 5605-24", 5507, 5537)




\* Foleja e rrjetit është vetëm për modelet në Mbretërinë e Bashkuar

## Pajisja e videos

HDMI (Televizorët e serive 4503, 5503, 4304, 4354, 4504, 5304, 5605-32")

Për transmetimin e sinjalit me cilësi maksimale, përdorni kablllo HDMI të shpejtësisë së lartë dhe mos përdorni kablllo HDMI më të gjatë se 5 m.



\* Foleja e rrjetit është vetëm për modelet në Mbretërinë e Bashkuar

\*\* Foleja e satelitit është vetëm për serinë xxPxSxxxx


#### Mbrojtja nga kopjimi

Kabllo DVI dhe HDMI mbështesin HDCP (mbrojtje e materialeve dixhitale të shpejtësisë së lartë). HDCP është një sinjal i mbrojtjes nga kopjimi që parandalon kopjimin e materialeve nga disku DVD ose disku Blu-ray. Përmendet gjithashtu edhe si DRM (menaxhim i të drejtave dixhitale).


### HDMI (Televizorët e serive 5505, 5525, 5535, 5605-24", 5507, 5527, 5537)

Për transmetimin e sinjalit me cilësi maksimale, përdorni kablllo HDMI të shpejtësisë së lartë dhe mos përdorni kablllo HDMI më të gjatë se 5 m.

Për 32" e lart



Për 24"



\* Foleja e rrjetit është vetëm për modelet në Mbretërinë e Bashkuar

\*\* Foleja e satelitit është vetëm për serinë xxPxSxxxx

#### Mbrojtja nga kopjimi


Kabllo DVI dhe HDMI mbështesin HDCP (mbrojtje e materialeve dixhitale të shpejtësisë së lartë). HDCP është një sinjal i mbrojtjes nga kopjimi që parandalon kopjimin e materialeve nga disku DVD ose disku Blu-ray. Përmendet gjithashtu edhe si DRM (menaxhim i të drejtave dixhitale).

## HDMI - DVI (Televizorët e serive 4304, 4354, 5304, 5605-32")

Nëse keni ende pajisje që ka vetëm dalje DVI, mund ta lidhni me adaptor DVI-HDMI në folenë HDMI 2.

Përdorni përshtatës DVI-HDMI nëse pajisja ka vetëm lidhje DVI. Përdorni folenë HDMI 2 si dhe një kablo zëri majtas/djathtas (minifishë 3,5 mm) në hyrjen e zërit, në pjesën e pasme të televizorit.

Për 22"/24"



\* Foleja e rrjetit është vetëm për modelet në Mbretërinë e Bashkuar


\*\* Foleja e satelitit është vetëm për serinë xxPxSxxxx

## HDMI - DVI (Televizorët e serive 5505, 5525, 5535, 5605-24", 5507, 5537)

Nëse keni ende pajisje që ka vetëm dalje DVI, mund ta lidhni me adaptor DVI-HDMI në folenë HDMI 2.

Përdorni përshtatës DVI-HDMI nëse pajisja ka vetëm lidhje DVI. Përdorni folenë HDMI 2 si dhe një kablo zëri majtas/djathtas (minifishë 3,5 mm) në hyrjen e zërit, në pjesën e pasme të televizorit.

Për 24"




\* Foleja e rrjetit është vetëm për modelet në Mbretërinë e Bashkuar

\*\* Foleja e satelitit është vetëm për serinë xxPxSxxxx

## Lidhja HDMI-CEC - EasyLink

Lidhni pajisje që mbështesin "HDMI CEC" me televizorin - mund t'i komandoni me telekomandë. "EasyLink HDMI CEC" duhet të aktivizohet në televizor dhe në pajisjen e lidhur.



Aktivizimi i "EasyLink"

🏠 (Kryefaqja) > Cilësimet > Cilësimet e përgjithshme > EasyLink > EasyLink > Aktiv

Telekomandimi i pajisjeve që mbështesin "HDMI CEC".

🏠 (Kryefaqja) > Cilësimet > Cilësimet e përgjithshme > EasyLink > Telekomanda "EasyLink" > Aktive

Shënim:

- "EasyLink" mund të mos funksionojë me pajisje të markave të tjera.

- Funkcioni "HDMI CEC" ka emra të ndryshëm në marka të ndryshme. Disa shembuj janë: "Anynet",




"Aquos Link", "Bravia Theatre Sync", "Kuro Link", "Simplink" dhe "Viera Link". Jo të gjitha markat përputhen plotësisht me "EasyLink". Emrat e markave të "HDMI CEC" të përmendura si shembuj janë pronë e pronarëve të tyre përkatës.

## SCART (nëse ka)

SCART është një lidhje me cilësi të mirë.

Lidhja SCART mund të përdoret për sinjale video CVBS dhe RGB, por nuk mund të përdoret për sinjalet e televizorëve me rezolucion të lartë (HD). Lidhja SCART kombinon sinjalet e videos dhe të audios. Lidhja "SCART" mbështet edhe luajtje në format NTSC.

Për televizorët e serive 4503, 5503, 4304, 4354, 4504, 5304, 5605-32"



\* Foleja e rrjetit është vetëm për modelet në Mbretërinë e Bashkuar

\*\* Foleja e satelitit është vetëm për serinë xxPxSxxxx

5.6

## Pajisja e zërit

### HDMI ARC

HDMI ARC (Audio Return Channel; kanali i kthimit të zërit) ka vetëm HDMI 1 në televizor.


Nëse edhe pajisja, zakonisht sistem kinemaje në shtëpi (HTS), ka lidhje HDMI ARC, lidheni me HDMI 1 në televizor. Me lidhjen "HDMI ARC" nuk është e nevojshme të lidhni kabllo shtesë audioje që dërgon zërin e figurës së televizorit drejt sistemit të kinemasë.

Lidhja "HDMI ARC" i kombinon të dy sinjalet.

## Dalja e audios dixhitale (televizorët e serisë 4503, 5503, 4304, 4354, 4504, 5304, 5605-32")

Dalja e audios - Optike është lidhje zëri e cilësisë së lartë.

Kjo lidhje optike mund të transmetojë audio 5.1-kanalëshe. Nëse pajisja juaj, zakonisht sistemi i kinemasë (HTS), nuk ka lidhje HDMI ARC, mund ta përdorni këtë lidhje me lidhjen Dalja e audios - Optike në HTS. Lidhja Dalja e audios - Optike e dërgon zërin nga televizori në HTS.



\* Foleja e rrjetit është vetëm për modelet në Mbretërinë e Bashkuar

\*\* Foleja e satelitit është vetëm për serinë xxPxSxxxx

## Dalja e audios dixhitale (televizorët e serisë 5505, 5525, 5535, 5605-24", 5507, 5527, 5537)


Dalja e audios - Optike është lidhje zëri e cilësisë së lartë.

Kjo lidhje optike mund të transmetojë audio 5.1-kanalëshe. Nëse pajisja juaj, zakonisht sistemi i kinemasë (HTS), nuk ka lidhje HDMI ARC, mund ta përdorni këtë lidhje me lidhjen Dalja e audios - Optike në HTS. Lidhja Dalja e audios - Optike e dërgon zërin nga televizori në HTS.

Për 32" e lart




Për 24"



\* Foleja e rrjetit është vetëm për modelet në Mbretërinë e Bashkuar  
 \*\* Foleja e satelitit është vetëm për serinë xxPxSxxxx

### Kufjet (televizorët e serisë 4503, 5503, 4304, 4354, 4504, 5304, 5605-32")


Mund të lidhni një palë kufje në lidhjen në pjesën anësore të televizorit. Lidhja është minifole 3,5 mm. Volumin e kufjeve mund ta rregulloni veçmas.




### Kufjet (televizorët e serisë 5505, 5525, 5535, 5605-24", 5507, 5527, 5537)

Mund të lidhni një palë kufje në lidhjen në pjesën anësore të televizorit. Lidhja është minifole 3,5 mm. Volumin e kufjeve mund ta rregulloni veçmas.

Për 32" e lart



Për 24"



\* Foleja e rrjetit është vetëm për modelet në Mbretërinë e Bashkuar

\*\* Foleja e satelitit është vetëm për serinë xxPxSxxxx

5.7


## Kompjuteri

### HDMI - DVI (Televizorët e serive 4304, 4354, 5304, 5605-32")

Nëse keni ende pajisje që ka vetëm dalje DVI, mund ta lidhni me adaptor DVI-HDMI në folenë HDMI 2.

Përdorni përshtatës DVI-HDMI nëse pajisja ka vetëm lidhje DVI. Përdorni folenë HDMI 2 si dhe një kablo zëri majtas/djathtas (minifishë 3,5 mm) në hyrjen e zërit, në pjesën e pasme të televizorit.

Për 22"/24"



\* Foleja e rrjetit është vetëm për modelet në Mbretërinë e Bashkuar


\*\* Foleja e satelitit është vetëm për serinë xxPxSxxxx

### HDMI - DVI (Televizorët e serive 5505, 5525, 5535, 5605-24", 5507, 5537)

Nëse keni ende pajisje që ka vetëm dalje DVI, mund ta lidhni me adaptor DVI-HDMI në folenë HDMI 2.

Përdorni përshtatës DVI-HDMI nëse pajisja ka vetëm lidhje DVI. Përdorni folenë HDMI 2 si dhe një kablo zëri majtas/djathtas (minifishë 3,5 mm) në hyrjen e zërit, në pjesën e pasme të televizorit.

Për 24"




\* Foleja e rrjetit është vetëm për modelet në Mbretërinë e Bashkuar

\*\* Foleja e satelitit është vetëm për serinë xxPxSxxxx

### VGA (nëse ka)

Përdorni kablo VGA nëse pajisja ka vetëm dalje VGA. Përdorni folenë VGA si dhe një kablo zëri majtas/djathtas (minifishë 3,5 mm) në hyrjen e zërit, në pjesën e pasme të televizorit.

Për 22"/24" (seritë 4304, 4354, 5304)



Për 24" (seritë 5505, 5525, 5535, 5605-24", 5507, 5537)



\* Foleja e rrjetit është vetëm për modelet në Mbretërinë e Bashkuar

\*\* Foleja e satelitit është vetëm për serinë xxPxSxxxx

## Cilësimet ideale

🏠 (Kryefaqja) > Cilësimet > Figura > Të avancuara > Kompjuteri

Caktojini në Aktiv për të pasur cilësimet ideale të figurës për ta përdorur televizorin si monitor kompjuteri.

\* Ofrohet vetëm për burimet HDMI dhe VGA.

5.8

## Moduli CAM me kartë "Smart" - CI+

### Rreth CI+

Televizori është gati për modulin e hyrjes së kushtëzuar CI+.

Me CI+ mund të shikoni programe HD me pagesë, si p.sh. filma dhe sport, të cilat ofrohen nga operatorët televizivë dixhitalë në rajonin tuaj. Këto programe kodohen nga operatori televiziv dhe dekodohen me një modul të parapaguar CI+.

Kur abonoheni për programet e tyre me pagesë, operatorët televizivë dixhitalë ofrojnë modulin CI+ (moduli me hyrje të kushtëzuar - CAM) dhe një kartë shoqëruese "Smart". Këto programe kanë nivel të lartë mbrojtjeje nga kopjimi.

Kontaktoni operatorin televiziv dixhital për më tepër informacion mbi kushtet.



### Kartë "Smart"

Kur abonoheni për programet e tyre me pagesë, operatorët televizivë dixhitalë ofrojnë modulin CI+ (moduli me hyrje të kushtëzuar - CAM) dhe një kartë shoqëruese "Smart".

Futni kartën "Smart" në modulin CAM. Shihni udhëzimet e marra nga operatori.


Për të futur modulin CAM në televizor...

1. Shihni në modulin CAM për mënyrën e saktë të futjes. Futja e pasaktë mund ta dëmtojë modulin CAM dhe televizorin.
2. Ndërsa shihni në pjesën e pasme të televizorit, me modulin CAM të drejtuar nga vetja, futeni me kujdes në folenë **COMMON INTERFACE**.
3. Shtyjeni modulin CAM deri në fund. Lëreni gjithnjë në fole.



Kur ndizni televizorin, mund të duhet pak kohë për aktivizimin e modulit CAM. Nëse keni futur modulin CAM dhe keni paguar tarifat e abonimit (format e abonimit mund të ndryshojnë), mund t'i shikoni kanalet e koduara që mbështeten nga karta "Smart" e modulit CAM.

Moduli CAM dhe karta "Smart" janë ekskluzivisht për televizorin tuaj. Nëse e hiqni modulin "CAM", nuk do të mund t'i shikoni më kanalet e koduara të mbështetura nga moduli CAM.

Për televizorët e serive 4503, 5503, 4304, 4354, 4504, 5304, 5605-32"



Për televizorët e serive 5505, 5525, 5535, 5605-24", 5507, 5527, 5537




Për televizorët e serive 5505, 5525, 5535, 5605-24", 5507, 5527, 5537

## Shikojeni kanalën në kartën "Smart"

Mund të shikoni kanale të instaluar nga kartat CI/CAM.

1. Ndërkohë që shikoni një kanal televiziv, shtypni **LIST** për të hapur listën e kanaleve.
2. Zgjidhni: Lista e kanaleve CI+ .



## Vendosja e fjalëkalimeve dhe i kodeve PIN

Për disa module CAM duhet të jepni një kod PIN për t'i parë kanalet. Kur caktoni kodin PIN për modulën CAM, ju rekomandojmë të përdorni të njëjtin kod që përdorni për kyçjen e televizorit.

Për të caktuar kodin PIN për modulën CAM...

**🏠** (Kryefaqja) > **Cilësimet** > **Kyçja për fëmijët** > **Kodi PIN i modulit CAM**

5.9

## Pajisja USB

### Njësia "Flash USB"

Mund t'i shikoni fotot dhe të luani muzikën dhe videot tuaja nga njësia e lidhur "Flash USB". Futni një njësia "Flash USB" në lidhjen **USB** në televizor ndërkohë që ky i fundit është i ndezur.

Televizori do të diktojë njësinë Flash dhe do të hapë një listë që shfaq përmbajtjet e saj. Nëse lista e përmbajtjeve nuk shfaqet automatikisht, shtypni **SOURCES** dhe zgjidhni **USB**.

Për televizorët e serive 4503, 5503, 4304, 4354, 4504, 5304, 5605-32"

## Disku USB

Nëse lidhni një disk USB, mund të pushoni ose të regjistroni teletransmetime dixhitale (transmetime DVB ose të ngjashme).


### Hapësira minimale e diskut

- Për të ndaluar një transmetim, ju duhet një njësia disku e pajtueshme me USB me minimumi 4 GB hapësirë.
- Për të ndaluar dhe regjistruar një transmetim, ju duhet minimumi 32 GB hapësirë disku.


Përpara se të mund të pushoni ose të regjistroni një transmetim, duhet të lidhni dhe të formatoni diskun USB. Formatimi fshin të gjithë skedarët nga disku USB.

\* Modelet për Turqinë nuk mbështetin regjistrimin dhe pushimin në pauzë të televizorit.

Për televizorët e serive 4503, 5503, 4304, 4354, 4504, 5304, 5605-32"



Për televizorët e serive 5505, 5525, 5535, 5605-24", 5507, 5527, 5537



### Paralajmërim

Disku USB formatohet ekskluzivisht për këtë televizor dhe nuk mund t'i përdorni regjistrimet e ruajtura në një kompjuter apo televizor tjetër. Mos i kopjoni apo ndryshoni skedarët e regjistrimit në diskun USB me aplikacione kompjuterike. Kjo do t'i dëmtonte regjistrimet. Kur formatoni një disk tjetër USB, materialet në diskun e parë humbin. Disku USB i instaluar në televizor duhet të riformatohet për përdorim me kompjuter.

5.10

## Rrjeti me tela - "Freeview" (foleja e rrjetit ofrohet vetëm për modelet e Mbretërisë së Bashkuar)

### Rrjeti


#### Rreth rrjetit

Foleja dhe funksioni i rrjetit janë vetëm për veçoritë e transmetimit "Freeview HD".

Lidhuni me rrjetin (televizorë të serive 4503, 5503, 4304, 4354, 4504, 5304)

Për të lidhur televizorin me internetin, nevojitet një rrugëzues rrjeti me lidhje me internetin.

Përdorni lidhje të shpejtësisë së lartë (brezgjerë) me internetin.



### Kryerja e lidhjes

Për të vendosur lidhjen me tela...

1. Lidhni rrugëzuesin me televizorin me kabllo rrjeti (kabllo "Ethernet"\*\*\*).
2. Sigurohuni që rrugëzuesi të jetë ndezur.
3. Shtypni **⬆** (Kryefaqja) , zgjidhni **Cilësimet > Rrjeti** dhe shtypni **➤** (djathtas) për t'u futur në meny.
4. Zgjidhni **Lidhje me rrjetin** dhe shtypni **OK**
5. Zgjidhni **Me tel** dhe shtypni **OK**. Televizori kërkon vazhdimisht për lidhje në rrjet.
6. Pasi lidhja të kryhet me sukses do të shfaqet një mesazh.


Nëse lidhja nuk arrihet, mund të kontrolloni konfigurimin e DHCP së rrugëzuesit. DHCP duhet të jetë aktive.

Lidhuni me rrjetin (televizorë të serive 5505, 5525, 5535, 5507, 5527, 5537)


Për të lidhur televizorin me internetin, nevojitet një rrugëzues rrjeti me lidhje me internetin.

Përdorni lidhje të shpejtësisë së lartë (brezgjerë) me internetin.

Për 32" e lart



Për 24"



## Kryerja e lidhjes

Për të vendosur lidhjen me tela...

1. Lidhni rrugëzuesin me televizorin me kabllo rrjeti (kabllo "Ethernet"\*\*\*).
2. Sigurohuni që rrugëzuesi të jetë ndezur.
3. Shtypni **🏠** (Kryefaqja) , zgjidhni **Cilësimet > Rrjeti** dhe shtypni **➤** (djathtas) për t'u futur në meny.
4. Zgjidhni **Lidhje me rrjetin** dhe shtypni **OK**
5. Zgjidhni **Me tel** dhe shtypni **OK**. Televizori kërkon vazhdimisht për lidhje në rrjet.
6. Pasi lidhja të kryhet me sukses do të shfaqet një mesazh.

Nëse lidhja nuk arrihet, mund të kontrolloni konfigurimin e DHCP së rrugëzuesit. DHCP duhet të jetë aktive.

---

## Cilësimet e rrjetit

**🏠** (Kryefaqja) > Cilësimet > Rrjeti > Shfaq cilësimet e rrjetit

Këtu mund të shikoni të gjitha cilësimet aktuale të rrjetit. Adresa IP dhe MAC, fuqia e sinjalit, shpejtësia, mënyra e enkriptimit etj.

**🏠** (Kryefaqja) > Cilësimet > Rrjeti > Konfigurimi i rrjetit

Nëse jeni përdorues i avancuar dhe dëshironi ta instaloni rrjetin me adresë statike IP, caktojini televizorin në **IP statike**.

Zgjidhni **Konfigurimi i IP statike** dhe konfiguroni lidhjen. Mund të caktoni numrin për opsionet **Adresa IP**, **Maska e rrjetit**, **Portëkalimi**, **DNS**.





---

# Ndërrimi i burimit

---

## 6.1

### Lista e burimeve







- Për të hapur menynë e burimeve, shtypni  SOURCES .
- Për të kaluar te një pajisje e lidhur, zgjidhni pajisjen me shigjeta  (lart) ose  (poshtë) dhe shtypni **OK**.
- Për ta mbyllur menynë e burimeve pa e ndërruar pajisjen, shtypni sërish  SOURCES.

---

## 6.2

### Riemërtimi i pajisjes

- Mund të riemërtohen apo t'u zëvendësohet ikona vetëm burimeve HDMI, VGA (nëse ka), SCART (nëse ka)

1. Shtypni  SOURCES dhe zgjidhni HDMI ose VGA (nëse ka).
2. Shtypni  Modifikim dhe shtypni **OK**.
3. Zgjidhni njëren nga ikonat e pajisjeve dhe shtypni **OK**, emri i paracaktuar shfaqet në fushën e shkrimit.
4. Zgjidhni **Rename**, pastaj shkruani një emër të ri duke përdorur tastierën virtuale.
  - Shtypni tastin  (e kuq) për të shkruar me shkronja të vogla
  - Shtypni tastin  (e gjelbër) për të shkruar me shkronja të mëdha
  - Shtypni tastin  (e verdhë) për të shkruar numra dhe simbole
  - Shtypni tastin  (e kaltër) për të fshirë një shkronjë
5. Zgjidhni **Fund** pasi të keni përfunduar modifikimin.



# Kanalet

## 7.1

### Rreth kanaleve dhe ndërrimit të tyre

#### Shikimi i kanaleve televizive

- Shtypni . Televizori sintonizohen në kanalën që keni parë të fundit.
- Shtypni (Home) > Channels dhe pastaj shtypni OK.
- Shtypni + ose - për të ndërruar kanalet.
- Nëse e dini numrin e kanalit, shkruajeni numrin me tastet numerike. Shtypni OK pas vendosjes së numrit për ndërrimin e kanaleve.
- Për t'u kthyer sërish te kanali i mëparshëm, shtypni BACK .

#### Për të kaluar në një kanal nga lista e kanaleve

- Gjatë shikimit të një kanali televiziv, shtypni LIST për të hapur listën e kanaleve.
- Lista e kanaleve mund të ketë faqe të ndryshme me kanale. Për të parë faqen e mëparshme apo të mëpasme, shtypni + ose -.
- Për t'i mbyllur listat e kanaleve pa i ndërruar kanalet, shtypni sërish LIST .

#### Ikonat e kanaleve

Pas një përditësimi automatik të listës së kanaleve, kanalet e gjetura rishtas shënohen me një (yll). Nëse e kyçni një kanal, ai shënohet me një (kyç).

#### Kanalet radiofonike

Nëse ka transmetim dixhital, stacionet dixhitale radiofonike instalohen gjatë instalimit. Kaloni në një kanal radioje njëlloj si me kanalet televizive.

Ky televizor mund të marrë sinjal standard dixhital televiziv DVB. Televizori mund të mos funksionojë siç duhet me disa operatorë televizionesh dixhitale që nuk pajtohen plotësisht me specifikimet e standardit.

## 7.2

### Instalimi i kanalit

#### Antena dhe kabllori

##### Kërkimi manual për kanale dhe cilësimet e tyre

##### Kërkimi për kanale

##### Përditësimi i listës ekzistuese të kanaleve

(Kryefaqja) > Cilësimet > Instalimi i

antenës/kabllorit > Kërkimi për kanale > Përditësimi i kanaleve

##### Riinstalimi i të gjitha kanaleve

(Kryefaqja) > Cilësimet > Instalimi i antenës/kabllorit > Kërkimi për kanale > Riinstalimi i kanaleve

1. Zgjidhni shtetin ku ndodhëni dhe shtypni OK.
2. Zgjidhni Antena (DVB-T) ose Kabllori (DVB-C) , dhe zgjidhni një artikull që duhet të riinstaloni.
3. Zgjidhni Kanalet dixhitale dhe analoge, Vetëm kanalet dixhitale ose Vetëm kanalet analoge.
4. Zgjidhni Nisja dhe shtypni OK për të përditësuar kanalet. Kjo mund të zgjasë disa minuta.

##### Cilësimet e kanaleve

(Kryefaqja) > Cilësimet > Instalimi i antenës/kabllorit > Kërkimi për kanale > Riinstalimi i kanaleve

1. Zgjidhni shtetin ku ndodhëni dhe shtypni OK.
2. Zgjidhni Antena (DVB-T) ose Kabllori (DVB-C) , dhe zgjidhni një artikull që duhet të riinstaloni.
3. Zgjidhni Kanalet dixhitale dhe analoge, Vetëm kanalet dixhitale ose Vetëm kanalet analoge.
4. Zgjidhni Cilësimet dhe shtypni OK.
5. Shtypni (i kuq) për t'i rivendosur, ose shtypni (i gjelbër) pasi të keni përfunduar cilësimet.

##### Frequency scan

Zgjidhni mënyrën e kërkimit për kanale.

- **Quick:** zgjidhni mënyrën më të shpejtë dhe përdorni cilësimet e paracaktuara që përdoren nga shumica e operatorëve kabllorë në shtetin tuaj.
- **Full:** Nëse kjo mënyrë nuk jep kanale të instaluar ose nëse mungojnë disa kanale, mund të zgjidhni mënyrën e zgjeruar **Kërkim i plotë**. Kjo mënyrë kërkon më shumë kohë për kërkimin dhe instalimin e kanaleve.
- **Advanced:** Nëse keni marrë një vlerë specifike të frekuencës së rrjetit për kërkimin e kanaleve, zgjidhni **I avancuar**.

##### Frekuenca e rrjetit

Nëse për kërkimin e kanaleve synoni të përdorni metodën **Kërkim i shpejtë** te **Kërkimi i frekuencave**, zgjidhni opsionin **Automatik**. Televizori do të përdorë 1 nga frekuencat e paracaktuara të rrjetit (ose HC - kanal lokalizues) që përdoret nga shumica e operatorëve kabllorë në shtetin tuaj. Nëse keni marrë një vlerë specifike të frekuencës së rrjetit për kërkimin e kanaleve, zgjidhni **Manual**.

##### Frekuenca e rrjetit

Me modalitetin **Frekuenca e rrjetit** të caktuar në **Manual**, mund ta jepni këtu vlerën e frekuencës së rrjetit që morët nga operatori. Për të dhënë vlerën, përdorni tastet me ngjyrë.

## Modaliteti i shpejtësisë së modulimit

Nëse operatori kabllor nuk ju ka dhënë një vlerë specifike të shpejtësisë së modulimit për të instaluar kanalet televizive, lëreni cilësimin e modalitetit të shpejtësisë së modulimit në **Automatik**.

Nëse keni marrë një vlerë specifike të shpejtësisë së modulimit, zgjidhni **Manual**.

### Shpejtësia e modulimit

Me **Modaliteti i shpejtësisë së modulimit** të caktuar në **Manual**, mund të jepni shpejtësinë e modulimit nëpërmjet tasteve numerike.

### Të hapura / të koduara

Nëse keni pajtim dhe modul CAM – modul me hyrje të kushtëzuar për shërbimet televizive me pagesë, zgjidhni **Të hapura + të koduara**. Nëse nuk keni pajtim për shërbime dhe kanale me pagesë, mund të zgjidhni **Vetëm kanalet e hapura**.

---

## Kërkimi automatik i kanaleve

🏠 (Kryefaqja) > Cilësimet > Instalimi i antenës/kabllorit > Përditësimi automatik i kanaleve

Nëse merrni kanale dixhitale, mund ta caktoni televizorin që ta përditësojë automatikisht listën me kanalet e reja.

Përndryshe, mund ta bëni vetë.

### Automatic channel update

Televizori i përditëson kanalet një herë në ditë, në orën 06:00 dhe ruan kanalet e reja. Kanalet e reja ruhen në listën "Të gjitha kanalet", por edhe në listën "Kanalet e reja". Kanalet boshe do të hiqen.

Me ndezjen e televizorit shfaqet një mesazh nëse gjenden kanale të reja ose nëse kanalet janë përditësuar ose hequr. Për të bërë përditësimin automatik të kanaleve, televizori duhet të jetë në modalitet pritjeje.

---

## Mesazhi i përditësimit të kanaleve

🏠 (Kryefaqja) > Cilësimet > Instalimi i antenës/kabllorit > Mesazhi i përditësimit të kanaleve

Me ndezjen e televizorit shfaqet një mesazh nëse gjenden kanale të reja ose nëse kanalet janë përditësuar ose hequr. Për të shmangur shfaqjen e këtij mesazhi pas çdo përditësimi të kanaleve, mund ta çaktivizoni.

---

## Dixhital: Testi i marrjes

🏠 (Kryefaqja) > Cilësimet > Instalimi i antenës/kabllorit > Dixhital: Testi i marrjes

Shfaqet frekuenca dixhitale për këtë kanal. Nëse marrja është e dobët, mund ta ripoziciononi antenën.

Për të kontrolluar sërish cilësinë e sinjalit të kësaj frekuence, zgjidhni **Kërkim** dhe shtypni **OK**.

Për të dhënë manualisht një frekuencë specifike, përdorni tastet numerike të telekomandës.

Përndryshe, zgjidhni frekuencën, poziciononi shigjetën mbi një numër me **<** dhe **>** dhe ndryshoni numrin me **▲** dhe **▼**. Për të verifikuar frekuencën, zgjidhni **Kërkim** dhe shtypni **OK**.

Nëse përdorni DVB-C për të marrë kanalet, ofrohet opsioni **Modaliteti i shpejtësisë së modulimit**. Për modalitetin e shpejtësisë së modulimit, zgjidhni **Automatik**, nëse operatori kabllor nuk ju ka dhënë vlerë specifike të shpejtësisë së modulimit. Për të dhënë vlerën e shpejtësisë së modulimit, zgjidhni **Shpejtësia e modulimit** dhe përdorni tastet numerike ose **▲** dhe **▼**.

---

## Analog: Instalimi manual

🏠 (Kryefaqja) > Cilësimet > Instalimi i antenës/kabllorit > Analog: Instalimi manual

Kanalet analoge televizive mund të instalohen manualisht, kanal pas kanali.

### Sistemi

Për të konfiguruar sistemin e televizorit, zgjidhni **Sistemi**.

Zgjidhni shtetin tuaj ose vendin ku ndodhni aktualisht dhe shtypni **OK**.

### Search Channel

Për të gjetur një kanal, zgjidhni **Search channel** dhe shtypni **OK**. Mund të jepni vetë një frekuencë për të gjetur një kanal ose të lini ta kërkojë televizori.

Shtypni **OK**, zgjidhni **Kërkim** dhe shtypni **OK** për të kërkuar automatikisht një kanal. Kanali i gjetur do të shfaqet në ekran dhe nëse marrja është e dobët, shtypni sërish **Kërkim**. Nëse dëshironi ta ruani kanalën, zgjidhni **Fund** dhe shtypni **OK**.

### Sintonizimi

Për të sintonizuar një kanal, zgjidhni **Sintonizimi** dhe shtypni **OK**. Mund të sintonizoni kanalën me **▲** ose **▼**.

Nëse dëshironi ta ruani kanalën e gjetur, zgjidhni **Fund** dhe shtypni **OK**.

### Ruajtja

Kanalën mund ta ruani në numrin aktual të kanalit ose në një numër të ri.

Zgjidhni **Ruajtja** dhe shtypni **OK**. Numri i kanalit të ri do të shfaqet shkurtimisht.

Këto hapa mund t'i kryeni sërish derisa të keni gjetur të gjitha kanalet e ofruara analoge.

---

## Satelitor (nëse ka)

---

### Rreth instalimit të satelitëve

#### Deri në 4 satelitë

Në këtë televizor mund të instalohen deri në 4 satelitë (4 koka LNB). Zgjidhni numrin e saktë të satelitëve që dëshironi të instaloni në fillim të instalimit. Kjo do ta shpejtonte instalimin.

#### Unicable

Për të lidhur antenën me televizorin mund të përdorni sistem "Unicable". Në fillim të instalimit mund të zgjidhni "Unicable" për 1 ose 2 satelitë.

#### MDU - njësi shumëpozicionale

Sintonizuesit e integruar satelitorë mbështesin MDU në satelitët "Astra" dhe për Digiturk në satelitin "Eutelsat". MDU nuk mbështetet në "Türksat".

---

### Fillimi i instalimit

---

#### Përditësimi i kanaleve

[🏠 \(Kryefaqja\)](#) > [Cilësimet](#) > [Instalimi i satelitorit](#) > [Kërkimi për satelitë](#) > [Përditësimi i kanaleve](#)

Përditësimin manual të kanaleve mund ta bëni në çdo çast - do të shtohen kanale të reja dhe kanalet e padisponueshme do të hiqen.

Jepni kodin PIN nëse nevojitet.

---



#### Riinstalimi i kanaleve

[🏠 \(Kryefaqja\)](#) > [Cilësimet](#) > [Instalimi i satelitorit](#) > [Kërkimi për satelitë](#) > [Riinstalimi i kanaleve](#)

Mund t'i kërkonti sërish manualisht satelitët dhe kanalet.

1. Zgjidhni një opsion që duhet të riinstaloni.
2. Zgjidhni [Cilësimet](#) ose zgjidhni [Nisja](#) për të përditësuar kanalet.

#### Menyja "Cilësimet"

Shtypni  Rivendosje për t'i rivendosur, ose shtypni  Fund pasi të keni përfunduar cilësimet.

#### - Connection type

Zgjidhni numrin e satelitëve që dëshironi të instaloni. Televizori e cakton automatikisht llojin e përshtatshëm të lidhjes.

• Deri në 4 satelitë - Mund të instaloni deri në 4 satelitë (4 koka LNB) në televizor. Zgjidhni numrin e

saktë të satelitëve që dëshironi të instaloni në fillim të instalimit. Kjo do ta shpejtonte instalimin.

• **Unicable** - Për të lidhur antenën parabolike me televizorin mund të përdorni sistemin "Unicable". Në fillim të instalimit mund të zgjidhni "Unicable" për 1 ose 2 satelitë.

#### - Cilësimet e kokave LNB

Në disa shtete, mund të rregulloni cilësimet për përdoruesit ekspertë për transponderët lokalizues dhe çdo kokë LNB. Përdorini ose ndryshojini këto cilësime vetëm nëse nuk bëhet dot instalimi normal. Këto cilësime mund t'i përdorni për të anuluar ato normale nëse keni pajisje jostandarde satelitore. Disa operatorë mund t'ju japin disa vlera transponderi ose koke LNB të cilat mund t'i vendosni këtu.

- Energjia e kokës LNB - Në cilësimin bazë, energjia e kokës LNB është e caktuar në "Aktive".
- Toni 22 kHz - Në cilësimin bazë, "Toni" është i caktuar në "Automatik".
- Frekuenca e ulët LO / Frekuenca e lartë LO - Frekuenat e oshilatorit lokal caktohen në vlerat standarde. Rregullojini vlerat vetëm në rast pajisjesh të posaçme që kërkojnë vlera të ndryshme.

Jepni kodin PIN nëse nevojitet.

---

### Shtimi ose heqja e satelitit

[🏠 \(Kryefaqja\)](#) > [Cilësimet](#) > [Instalimi i satelitorit](#) > [Kërkimi për satelitë](#) > [Shtim sateliti ose Heqje sateliti](#)

[🏠 \(Kryefaqja\)](#) > [Cilësimet](#) > [Instalimi i satelitorit](#) > [Kërkimi për satelitë](#) > [Shtim sateliti](#)

- Instalimit aktual të satelitorit mund t'i shtoni një satelit shtesë. Satelitët e instaluar dhe kanalet e tyre nuk preken. Disa operatorë satelitorë nuk e lejojnë shtim satelitësh.
- Sateliti shtesë duhet të shihet si suplementar. Nuk ka të bëjë me abonimin në satelitin kryesor apo me vetë satelitin kryesor paketën e kanaleve të të cilit përdorni. Rëndom 3 satelitëve të instaluar, do t'i shtonit edhe një satelit të 4-rt. Nëse keni të instaluar 4 satelitë, shihni mundësinë e heqjes së njërit prej tyre përpara se të mund të shtoni satelit të ri.
- Nëse keni aktualisht të instaluar vetëm 1 ose 2 satelitë, cilësimet e instalimit aktual mund të mos e lejojnë shtimin e një sateliti tjetër. Nëse ju duhet t'i ndryshoni këto cilësime, duhet të kryeni sërish instalimin e plotë të satelitit. Nëse nevojitet ndryshimi i cilësimeve, nuk është e mundur të përdoret opsioni **Shto satelit**.


[🏠 \(Kryefaqja\)](#) > [Cilësimet](#) > [Instalimi i satelitorit](#) > [Kërkimi për satelitë](#) > [Heqje sateliti](#)

Nga instalimi i satelitëve aktualë mund të hiqni një a më shumë satelitë. Sateliti hiqet së bashku me kanalet e tij. Disa operatorë satelitorë nuk e ofrojnë heqjen e satelitëve.

---

## Lista e kanaleve satelitore

🏠 (Kryefaqja) > Cilësimet > Instalimi i satelitorit > Lista e kanaleve satelitore

Mund të zgjidhni listën e preferuar të kanaleve satelitore kur shtypni  LIST për të hapur kanalet satelitore.

Satelitët mund të ofrojnë paketa që përmbledhin kanale të hapura (transmetime falas) dhe mundësojnë një renditje në përshtatje me shtetin përkatës. Disa satelitë ofrojnë paketa abonimi - një përmbledhje kanalesh me pagesë.

Zgjidhni **Nga një paketë me kanale të renditura** për të instaluar vetëm kanalet e paketës ose zgjidhni **Të gjitha kanalet e përenditura** për të instaluar paketën së bashku me të gjitha kanalet e tjera të mundshme. Për paketat e pajtimit, rekomandojmë instalimin e shpejtë. Ju rekomandojmë një instalim të plotë nëse keni satelitë shtesë të cilët nuk janë pjesë e paketës suaj të pajtimit. Të gjitha kanalet e instaluar vendosen në listën e kanaleve.

---

## Kërkimi automatik i kanaleve

🏠 (Kryefaqja) > Cilësimet > Instalimi i satelitorit > Përditësimi automatik i kanaleve

Nëse merrni kanale dixhitale, mund ta caktoni televizorin që ta përditësojë automatikisht listën me kanalet e reja.

Përndryshe, mund ta bëni vetë.

## Përditësimi automatik i kanaleve

Televizori i përditëson kanalet një herë në ditë, në orën 06:00 dhe ruan kanalet e reja. Kanalet e reja ruhen në listën "Të gjitha kanalet", por edhe në listën "Kanalet e reja". Kanalet boshe do të hiqen. Me ndezjen e televizorit shfaqet një mesazh nëse gjenden kanale të reja ose nëse kanalet janë përditësuar ose hequr. Për të bërë përditësimin automatik të kanaleve, televizori duhet të jetë në modalitet pritjeje.

---

## Mesazhi i përditësimit të kanaleve

🏠 (Kryefaqja) > Cilësimet > Instalimi i satelitorit > Mesazhi i përditësimit të kanaleve

Me ndezjen e televizorit shfaqet një mesazh nëse gjenden kanale të reja ose nëse kanalet janë përditësuar ose hequr. Për të shmangur shfaqjen e

këtij mesazhi pas çdo përditësimi të kanaleve, mund ta çaktivizoni.

---

## Instalimi manual

🏠 (Kryefaqja) > Cilësimet > Instalimi i satelitorit > Instalimi manual

Instalimi manual i satelitit.

- Koka LNB - zgjidhni kokën LNB për të cilën dëshironi të shtoni kanale të reja.
- Polarizimi - Zgjidhni polarizimin që ju nevojitet.
- Modaliteti i shpejtësisë së modulimit - Zgjidhni "Manual" për të dhënë shpejtësinë e modulimit.
- Frekuenca - Jepni frekuencën e transponderit.
- Kërkim - Kërkoni për transponder.

---

## Zgjidhja e problemeve

Televizori nuk i gjen satelitët që dua ose televizori instalon të njëjtin satelit dy herë

- Sigurohuni që në fillim të instalimit të jetë caktuar numri i saktë i satelitëve të "Cilësimet". Televizorin mund ta caktoni të kërkojë për një, dy ose 3/4 satelitë.

Koka LNB dyshe nuk gjen dot satelit të dytë

- Nëse televizori gjen njërin satelit, por nuk gjen dot të dytin, rrotullojeni me disa gradë antenën parabolike. Pozicionojeni në mënyrë që të marrë sinjalin më të fortë të satelitit të parë. Kontrolloni treguesin e fuqisë së sinjalit të satelitit të parë në ekran. Me satelitin e parë të caktuar në sinjalin më të fortë, zgjidhni sërish "Kërko" për të gjetur satelitin e dytë.  
- Sigurohuni që cilësimet të jenë caktuar të "Dy satelitë".

Ndryshimi i cilësimeve të instalimit nuk e zgjidhni problemin

- Të gjitha cilësimet, satelitët dhe kanalet ruhen vetëm pas përfundimit të instalimit.

Janë zhdukur të gjitha kanalet satelitore

- Nëse përdorni sistem "Unicable", sigurohuni që të cilësimet të caktoni dy numra unikë bande përdoruesi për të dy marrësit e integruar. Mund të ndodhë që një marrës tjetër satelitor në sistemin "Unicable" të përdorë të njëjtin numër bande përdorimi.

Disa kanale satelitore duket se janë zhdukur nga lista e kanaleve

- Nëse disa kanale nuk figurojnë më apo kanë lëvizur, transmetuesi mund të ketë ndryshuar vendndodhjen e transponderit të këtyre kanaleve. Për të rivendosur pozicionet e kanaleve të lista e kanaleve, mund të provoni të përditësoni paketat e kanaleve.

## Nuk heq dot një satelit

- Paketat e pajtimit nuk lejojnë heqjen e satelitëve.  
Për të hequr satelitin, duhet të kryeni sërish instalimin e plotë dhe të zgjidhni një paketë tjetër.

## Ndonjëherë sinjali i marrjes është i dobët

- Kontrolloni nëse antena parabolike është montuar mirë. Era e fortë mund ta lëvizë antenën parabolike.  
- Bora dha shiu mund të ulin cilësinë e marrjes.

---

## Kopjimi i listës së kanaleve

---

### Hyrje

Kopjimi i listës së kanaleve synohet për shitësit dhe përdoruesit ekspertë.

Me funksionin **Kopjimi i listës së kanaleve**, kanalet e instaluar në televizor mund t'i kopjoni drejt një televizori tjetër "Philips" të së njëjtës gamë. Me funksionin **Kopjimi i listës së kanaleve**, shmangni kërkimin e tepruar të kanaleve, duke ngarkuar në televizor një listë kanalesh të paracaktuara. Përdorni njësi "Flash USB" prej së paku 1 GB.

### Kushtet

- Të dy televizorët i përkasin së njëjtës periudhë prodhimi. Kontrolloni emrin e modelit të televizorit me shifrën e fundit. (Për shembull: te xxPxx4xx4, 4 d.m.th. produkt i vitit 2019)

- Të dy televizorët kanë versione të pajtueshme softueri.

---

### Kopjimi i një liste kanalesh, kontrolli i versionit të saj

Për të kopjuar listën e kanaleve...

1. Ndizni televizorin. Televizori duhet të ketë kanale të instaluar.
2. Lidhni një njësi "Flash USB".
3. Shtypni **⏠ (Kryefaqja) > Cilësimet > Cilësimet e përgjithshme > Kopjimi i listës së kanaleve**.
4. Zgjidhni **Kopjim në USB** dhe shtypni **OK**. Për të kopjuar listën e kanaleve mund t'ju kërkohet të jepni kodin PIN të bllokimit për fëmijët.
5. Pas përfundimit të kopjimit, hiqeni njësinë "Flash USB".
6. Nëse është e nevojshme, shtypni vazhdimisht **⬅ (majtas)** për të mbyllur menyën.

Tani mund ta ngarkoni listën e kopjuar e kanaleve drejt një televizori tjetër "Philips".

Kontrolloni versionin aktual të listës së kanaleve...

1. Shtypni **⏠ (Kryefaqja) > Cilësimet > Cilësimet e përgjithshme > Kopjimi i listës së kanaleve**.

2. Zgjidhni **Kopjimi i listës së kanaleve** dhe zgjidhni **Versioni aktual**, më pas shtypni **OK**.
3. Nëse është e nevojshme, shtypni vazhdimisht **⬅ (majtas)** për të mbyllur menyën.

---

### Ngarkimi i një liste kanalesh

---

#### Drejt televizorëve të painstaluar

Në varësi të instalimit ose jo të televizorit, për të ngarkuar listën e kanaleve duhet të përdoret një mënyrë tjetër.

#### Drejt një televizori ende të painstaluar

1. Për të filluar instalimin, futeni televizorin në prizë dhe zgjidhni gjuhën e shtetit. Mund ta anashkaloni kërkimin e kanaleve. Përfundoni instalimin.

2. Lidhni njësinë "Flash USB" që përmban listën e kanaleve të televizorit tjetër.

3. Për të filluar ngarkimin e listës së kanaleve, shtypni **⏠ (Kryefaqja) > Cilësimet > Cilësimet e përgjithshme > Kopjimi i listës së kanaleve > Kopjimi në televizor** dhe shtypni **OK**. Jepni kodin PIN nëse nevojitet.

4. Televizori do t'ju njoftojë nëse lista e kanaleve kopjohet me sukses në televizor. Hiqni njësinë "Flash USB".

---

#### Drejt televizorëve të instaluar

Në varësi të instalimit ose jo të televizorit, për të ngarkuar listën e kanaleve duhet të përdoret një mënyrë tjetër.

#### Drejt një televizori të instaluar

1. Verifikoni cilësimin e shtetit tek televizori. (Për ta verifikuar cilësimin, shikoni kapitullin **Riinstalimi i kanaleve**. Filloni këtë procedurë derisa të arrini cilësimin e shtetit. Shtypni **↩ BACK** për të anuluar instalimin.)

Nëse shteti është i saktë, vazhdoni me hapin 2. Nëse shteti nuk është i saktë, duhet të filloni një riinstalim. Shikoni kapitullin **Riinstalimi i kanaleve** dhe filloni instalimin. Zgjidhni shtetin e saktë dhe anashkaloni kërkimin e kanaleve. Përfundoni instalimin. Kur ta keni përfunduar, vazhdoni me hapin 2.

2. Lidhni njësinë "Flash USB" që përmban listën e kanaleve të televizorit tjetër.

3. Për të filluar ngarkimin e listës së kanaleve, shtypni **⏠ (Kryefaqja) > Cilësimet > Cilësimet e përgjithshme > Kopjimi i listës së kanaleve > Kopjimi në televizor** dhe shtypni **OK**. Jepni kodin PIN nëse nevojitet.

4. Televizori do t'ju njoftojë nëse lista e kanaleve

kopjohet me sukses në televizor. Hiqni njësinë "Flash USB".

---

## Opsionet e kanaleve



---

### Hapja e opsioneve

Mund të caktoni disa opsione ndërkohë që shikoni një kanal.

Në varësi të llojit të kanalit që po shikoni (analog ose dixhital) ose në varësi të cilësimeve të televizorit që keni caktuar, ju mundësohen disa opsione.

Për të hapur menynë e opsioneve...

1. Ndërkohë që shikoni një kanal, shtypni  **OPTIONS**.
2. Për ta mbyllur, shtypni sërish  **OPTIONS**.

---

### Titrat

Për të aktivizuar "Titrat", shtypni **SUBTITLE**.

Mund t'i kaloni titrat në **Titra aktive** ose **Titra joaktive**. Përndryshe mund të zgjidhni **Automatike**.

### Automatike

Nëse informacionet e gjuhës janë pjesë e transmetimit dixhital dhe programi i transmetuar nuk është në gjuhën tuaj (gjuha e caktuar në televizor), televizori mund të shfaqë automatikisht titrat në një nga gjuhët tuaja të preferuara. Njëra nga këto gjuhë titrash duhet të jetë edhe pjesë e transmetimit.

Gjuhët e preferuara të titrave mund t'i zgjidhni te **Gjuha e titrave**.

---

### Gjuha e titrave

Nëse nuk ofrohet asnjëra nga gjuhët e preferuara të titrave, mund të zgjidhni një gjuhë tjetër që ofrohet. Nuk e zgjidhni dot këtë opsion nëse nuk ofrohet asnjë gjuhë titrash.

---

### Gjuha e audios

Nëse nuk ofrohet asnjë nga gjuhët e preferuara të audios, mund të zgjidhni një gjuhë tjetër, nëse ofrohet. Nëse nuk ofrohet asnjë gjuhë audioje, nuk e zgjidhni dot këtë opsion.

---

### Dual I-II

Ky opsion ofrohet nëse sinjali i zërit përmban dy gjuhë audioje, por njëra nga gjuhët — ose të dyja — nuk ka tregues gjuhe.

---

### Ndërfaqja e përbashkët (CI)




Nëse ofrohet material cilësor me parapagesë nga një modul CAM, mund t'i caktoni cilësimet e operatorit me këtë opsion.

---

### Mono/stereo

Zërin e një kanali analog mund ta kaloni në "Mono" ose "Stereo".

Për të kaluar në "Mono" ose "Stereo"...

1. Sintonizohuni në një kanal analog.
2. Shtypni  **OPTIONS**, zgjidhni **Mono/Stereo** dhe shtypni  (djathtas).
3. Zgjidhni **Mono** ose **Stereo** dhe shtypni **OK**.
4. Nëse është e nevojshme, shtypni vazhdimisht  (majtas) për të mbyllur menynë.

---

### Statusi

Zgjidhni **Statusi** për të parë informacionin teknik rreth kanalit.

---

### Ora

Shfaqni orën në këndin e televizorit.

---





### 7.3

## Lista e kanaleve

---

### Hapja e listës së kanaleve

Për të hapur listën aktuale të kanaleve...

1. Shtypni , për të kaluar te televizori.
2. Shtypni  **LIST** për të hapur listën aktuale të kanaleve.
3. Shtypni  **OPTIONS** > **Zgjidh listën e kanaleve**, dhe zgjidhni një listë kanalesh që dëshironi të shikoni.
4. Shtypni sërish  **LIST** për të mbyllur listën e kanaleve.




---

### Opsionet e listës së kanaleve

---

#### Hapja e menysë "Opsionet"









Për të hapur menynë e opsioneve të listës së kanaleve...

1. Shtypni , për të kaluar te televizori.
2. Shtypni  **LIST** për të hapur listën aktuale të kanaleve.
3. Shtypni  **OPTIONS** dhe zgjidhni një nga opsionet.

4. Shtypni sërish  LIST për të mbyllur listën e kanaleve.

---


#### Riemërtimi i kanalit



1. Shtypni , për të kaluar te televizori.
2. Shtypni  LIST për të hapur listën aktuale të kanaleve.
3. Zgjidhni një kanal që doni të riemërtoni.
4. Shtypni  OPTIONS > Riemërtimi i kanalit dhe shtypni OK.
5. Në fushën e shkrimit, shtypni OK për të hapur tastierën virtuale, ose zgjidhni Fshehje për të fshehur tastierën në ekran.
6. Përdorni tastet e navigimit për të zgjedhur një shkronjë dhe më pas shtypni OK.
  - Shtypni tastin  (e kuq) për të shkruar me shkronja të vogla
  - Shtypni tastin  (e gjelbër) për të shkruar me shkronja të mëdha
  - Shtypni tastin  (e verdhë) për të shkruar numra dhe simbole
  - Shtypni tastin  (e kaltër) për të fshirë një shkronjë
7. Zgjidhni Fund pasi të keni përfunduar modifikimin.
8. Shtypni sërish  LIST për të mbyllur listën e kanaleve.


---

#### Krijimi ose modifikimi i listës së kanaleve të preferuara

 LIST >  OPTIONS > Krijimi i listës së preferencave

Zgjidhni një kanal dhe shtypni OK për ta shtuar në listën e kanaleve të preferuara dhe pasi të keni përfunduar, shtypni  Fund.

 LIST >  OPTIONS > Modifiko preferencat

Zgjidhni një kanal dhe shtypni OK për ta shtuar apo hequr nga një listë kanalesh të preferuara, pasi të përfundoni shtypni  Fund.

---



#### Zgjedhja e vargut të kanaleve

 LIST >  OPTIONS > Zgjedhje vargu kanalesh

Zgjidhni një varg kanalesh në një listë kanalesh të preferuara dhe pasi të keni përfunduar, shtypni OK.

---



#### Zgjedhja e listës së kanaleve

 LIST >  OPTIONS > Zgjidh listën e kanaleve

Zgjidhni një varg kanalesh në një listë kanalesh të preferuara dhe pasi të përfundoni, shtypni OK.

---

#### Kyçja, shkyçja e kanaleve

 LIST >  OPTIONS > Kyçja e kanalit, Shkyçja e kanalit

Kanalet mund t'i kyçni për të parandaluar shikimin nga fëmijët. Për të parë një kanal të kyçur, fillimisht duhet të jepni kodin PIN 4-shifror të funksionit Kyçja për fëmijët. Programet nuk i kyçni dot nga pajisjet e lidhura.




Kanali i kyçur do të ketë  përbri stemës së kanalit.


---

#### Kërkimi i kanaleve





 LIST >  OPTIONS > Kërkimi për kanal


Mund të kërkoni një kanal për ta gjetur në një listë të gjatë kanalesh.

1. Shtypni , për të kaluar te televizori.
2. Shtypni  LIST për të hapur listën aktuale të kanaleve.
3. Shtypni  OPTIONS > Kërkimi për kanal, dhe shtypni OK.

Në fushën e shkrimit, shtypni OK për të hapur tastierën virtuale, ose  BACK për ta fshehur.

Përdorni tastet e navigimit për të zgjedhur një shkronjë dhe më pas shtypni OK.

- Shtypni tastin  (e kuq) për të shkruar me shkronja të vogla
- Shtypni tastin  (e gjelbër) për të shkruar me shkronja të mëdha
- Shtypni tastin  (e verdhë) për të shkruar numra dhe simbole
- Shtypni tastin  (e kaltër) për të fshirë një shkronjë

4. Zgjidhni Fund pasi të keni përfunduar modifikimin.
5. Shtypni sërish  LIST për të mbyllur listën e kanaleve.

---

#### 7.4

### Zgjedhja e filtrit të kanaleve

 LIST >  OPTIONS > Zgjedhja e filtrit të kanaleve

Zgjidhni një nga kombinimet e kanaleve që shfaqen në listë.

## Kanalet e preferuara

### Rreth kanaleve të preferuara

Mund të krijoni një listë me kanale të preferuara e cila mban vetëm kanalet që dëshironi të shikoni. Kur zgjidhni listën e kanaleve të preferuara, kanalet e preferuara do t'i shihni vetëm kur ndërroni kanalet.

### Krijimi i një liste preferencash

1. Ndërkohë që shikoni një kanal televiziv, shtypni **≡ LIST** për të hapur listën e kanaleve.
2. Zgjidhni një kanal dhe shtypni **—** Piketim si të preferuar për ta shënuar si të preferuar.
3. Kanali i zgjedhur shënohet me një **♥**.
4. Për të mbaruar, shtypni **↩ BACK**. Kanalet shtohen në listën "Preferencat".

### Heqja e kanaleve nga lista e preferencave

Për të hequr një kanal nga lista e preferencave, zgjidhni kanalin me **♥**, më pas shtypni sërish **—** Shpiketo si kanal të preferuar për ta shpiketuar.

### Rirenditja e kanaleve

Kanalet e listës së preferencave mund t'i rirrendisni dhe lëvizni.

1. Ndërkohë që shikoni një kanal televiziv, shtypni **≡ LIST > ≡ OPTIONS >** zgjedhja e listës së kanaleve.
2. Zgjidhni **Antenë - Kanalet e preferuara**, **Kabllor - Kanalet e preferuara** ose **Satelitor - Kanalet e preferuara\*** dhe shtypni **OK**.
3. Shtypni **≡ OPTIONS** dhe zgjidhni **Rirendit kanalet**.
4. Zgjidhni kanalin për t'u rirrenditur dhe shtypni **OK**.
5. Shtypni **Butonat e shfletimit** për të lëvizur diku tjetër kanalin e zgjedhur dhe shtypni **OK**.
6. Pasi të keni përfunduar, shtypni **OK**.

\* Kanalet vetëm satelitor mund të kërkohen në modelet e televizorëve xxPxSxxxx.

## "Lista e preferencave" në "Guidën televizive"

"Guidën televizive" mund ta lidhni për "Listën e preferencave".

1. Ndërkohë që shikoni një kanal televiziv, shtypni **≡ LIST > ≡ OPTIONS >** zgjedhja e listës së kanaleve.
2. Zgjidhni **Antenë - Kanalet e preferuara**, **Kabllor - Kanalet e preferuara** ose **Satelitor - Kanalet e preferuara\*** dhe shtypni **OK**.
3. Shtypni **≡ TV GUIDE** për ta hapur.

Me "Guidën televizive" mund të shihni listën aktuale të programeve televizive dhe të programeve të planifikuara të kanaleve tuaja të preferuara. Ndër kanalet tuaja të preferuara, 3 kanalet e para më të përdorura nga lista bazë e transmetuesit do të bashkëngjiten pas kanaleve tuaja të preferuara për shikimin paraprak. Këto kanale duhet t'i shtosh në listën e preferencave për t'u lejuar komandimin (shih kapitullin "Guida televizive").

Në secilën faqe të "Guida televizive" ka një tabelë "A e dije se" që futet në listën e kanaleve të preferuara. Kanali "A e dinit" ofron këshilla të dobishme për të përmirësuar mënyrën sesi e përdorni televizorin.

\* Kanalet vetëm satelitor mund të kërkohen në modelet e televizorëve xxPxSxxxx.

## Teleteksti

### Faqet e teletekstit

Për të hapur teletekstin, shtypni **TEXT** ndërsa shikoni kanale televizive.  
Për ta mbyllur teletekstin, shtypni sërish **TEXT**.

### Zgjedhja e një faqeje teleteksti

Për të zgjedhur një faqe . . .

1. Shkruani numrin e faqes me tastet numerike.
2. Përdorni tastet me shigjetë për të lëvizur.
3. Shtypni një tast me ngjyrë për të zgjedhur një element me ngjyrë në pjesën e poshtme të ekranit.

### Nënfaqet e teletekstit

Një numër faqeje teleteksti mund të përmbajë disa nënfaqe. Numrat e nënfaqeve shfaqen në një shirit përbri numrit të faqes kryesore.  
Për të zgjedhur një nënfaqe, shtypni **<** ose **>**.

### Pasqyra e teletekstit Faqet e teletekstit

Disa transmetues ofrojnë pasqyrë Teleteksti.  
Për të hapur T.O.P. Faqet e teletekstit brenda funksionit "Teleteksti", shtypni **≡ OPTIONS** dhe




zgjidhni **Përmbledhje e pasqyrës**.

\* Teleteksti mund të hapet vetëm kur kanalet instalohen direkt në sintonizuesin e brendshëm të televizorit dhe ky i fundit është i caktuar në modalitetin e televizorit. Nëse përdoret një dekodues, teleteksti do të jetë i padisponueshëm nëpërmjet televizorit. Në këtë rast mund të përdoret teleteksti i dekoduesit.

---

### Opsionet e teletekstit

Te "Teleteksti", shtypni  **OPTIONS** për të zgjedhur të mëposhtmet...

- **Ngrirja e faqes**

Për të ndaluar shfletimin automatik të nënfaqeve.

- **Ekran i dyfishtë / Ekran i plotë**

Për të shfaqur kanal televiziv dhe teletekstin përbri njëri-tjetrit.

- **Përmbledhja e pasqyrës**

Për të hapur pasqyrën. teletekstit.

- **Zmadhim**

Për ta zmadhuar faqen e teletekstit për lexim komod.

- **Shfaqje**

Për të rishfaqur informacionin e fshehur në një faqe.

- **Qarkullimi i nënfaqeve**

Për të qarkulluar nënfaqet, nëse ka.

- **Gjuha**

Për të ndërruar grupin e germave që përdoren nga teleteksti për t'u shfaqur siç duhet.





---

### Konfigurimi i teletekstit

#### Gjuha e teletekstit

Disa teletransmetues dixhitalë ofrojnë disa gjuhë teleteksti.

Për të caktuar gjuhën kryesore dhe dytësore të teletekstit. . .

1. Shtypni , zgjidhni **Cilësimet > Rajoni dhe gjuha** dhe shtypni  (djathtas) për t'u futur në meny.
2. Zgjidhni **Gjuhët** dhe shtypni  (djathtas) për t'u futur në meny.
3. Zgjidhni **Teleteksti kryesor ose Teleteksti dytësor** dhe shtypni **OK**.
4. Zgjidhni gjuhën që dëshironi dhe shtypni **OK**.
5. Nëse është e nevojshme, shtypni vazhdimisht  (majtas) për të mbyllur menyën.

# Guida televizive

## 8.1

### Çfarë ju duhet

Me funksionin "Guida televizive" mund të shihni listën e programeve televizive dhe të programeve aktuale dhe të planifikuara të kanaleve tuaja. Në varësi të origjinës së informacionit (të të dhënave) të guidës televizive, do të shfaqen kanalet analoge dhe dixhitale ose vetëm kanalet dixhitale. Jo të gjitha kanalet televizive ofrojnë informacionin e guidës televizive.

Televizori mund të mbledhë informacion të guidës televizive për kanalet e instaluar (p.sh. kanalet që shikoni me funksionin "Shikimi televiziv"). Televizori nuk mund të mbledhë informacion të guidës televizive për kanalet e shikuara nga një marrës dixhital.

## 8.2

### Përdorimi i guidës televizive

#### Hapja e guidës televizive

Për të hapur guidën televizive, shtypni  TV GUIDE .

Shtypni sërish  TV GUIDE për ta mbyllur.

Herën e parë që hapni guidën televizive, televizori kontrollon të gjitha kanalet televizive për informacione programesh. Ky veprim mund të zgjasë disa minuta. Të dhënat e guidës televizive ruhen në televizor.

#### Sintonizimi në një program

##### Kalimi te një program


Nga guida televizive mund të kalosh në një program aktual.

Për të zgjedhur programin, përdor tastet me shigjetë për të theksuar emrin e programit.



Kaloni djathtas për të parë programet e planifikuar për më vonë atë ditë.


Për të ndërruar programin (kanalin), zgjidhni programin dhe shtypni OK.

##### Shfaqja e detajeve të programit

Për të shfaqur detajet e programit të zgjedhur, shtypni  INFO .

### Ndryshimi i ditës

Nëse informacioni i guidës televizive vjen nga transmetuesi, për të parë programin e një prej ditëve të ardhshme, shtypni  + . Shtypni  - për të kaluar te dita e mëparshme.



Përndryshe, mund të shtypni  OPTIONS dhe të zgjidhni **Ndrysho ditën**.

### Caktimi i një rikujtuesi




Mund të caktoni një rikujtues për një program. Do të njoftoheni me mesazh kur të fillojë programi. Mund të sintonizoheni menjëherë në këtë kanal.

Programet me rikujtues shënohen me një  (orë) te "Guida televizive".

Për të caktuar një rikujtues...


1. Shtypni  TV GUIDE dhe zgjidhni një program në vijim.
2. Shtypni  Cakto rikujtues dhe shtypni **OK**.

Për të spastruar një rikujtues...

1. Shtypni  TV GUIDE dhe zgjidhni një program me rikujtues, i cili është i shënuar me një  (orë).
2. Shtypni  Spastrimi i rikujtuesit, zgjidhni **Po**, dhe shtypni **OK**.

### Kërkimi sipas zhanrit

Nëse jepen informacione, programet e planifikuara mund t'i kërkoni sipas zhanrit si p.sh filma, sporte etj.





Për të kërkuar programet sipas zhanrit, shtypni  OPTIONS dhe zgjidhni **Kërkim sipas zhanrit**. Zgjidhni një zhanër dhe shtypni **OK**. Do të shfaqet një listë me programet e gjetura.

### Lista e rikujtuesve

Mund të shikoni një listë të rikujtuesve që keni caktuar.

#### Lista e rikujtuesve


Për të hapur listën e rikujtuesve...



1. Shtypni  TV GUIDE.
2. Shtypni  OPTIONS dhe zgjidhni **Të gjithë rikujtuesit**.
3. Zgjidhni rikujtuesin që doni të hiqni nga lista, i cili do të shënohet si .
4. Shtypni , zgjidhni **Spastrim i të zgjedhurave** dhe shtypni **OK**.
5. Zgjidhni **Mbyll** për të mbyllur listën e rikujtuesve.

---



## Vendosja e një regjistrimi (nuk vlen për modele për Turqinë)

Mund të caktoni një regjistrim të "Guida televizive".



Programi i caktuar për regjistrim do të shënohet me një  të "Guida televizive".

Për të parë listën e regjistrimeve, shtypni  **Regjistrimet**, programi i caktuar për regjistrim shënohet me një  (pikë të kuqe) përpara emrit të programit.

Për të regjistruar një program...

1. Shtypni  **TV GUIDE** dhe zgjidhni një program të ardhshëm ose aktual.
2. Shtypni tastin me ngjyrë  **Regjistro** .

Për të anuluar një regjistrim...

1. Shtypni  **TV GUIDE** dhe zgjidhni programin e caktuar për regjistrim.
2. Shtypni tastin me ngjyrë  **Spastrim i regjistrimit** .

# Regjistrimi i dhe pushimi i televizorit (nuk vlen për modelet për Turqinë)

## 9.1

### Çfarë ju duhet

Nëse lidhni një disk USB, mund të pushoni ose të regjistroni teletransmetime dixhitale (transmetime DVB ose të ngjashme).

#### Hapësira minimale e diskut

- Për të ndaluar një transmetim, ju duhet një njësi disku e pajtueshme me USB me minimumi 4 GB hapësirë.
- Për të ndaluar dhe regjistruar një transmetim, ju duhet minimumi 32 GB hapësirë disku.

Përpara se të mund të pushoni ose të regjistroni një transmetim, duhet të lidhni dhe të formatoni diskun USB. Formatimi fshin të gjithë skedarët nga disku USB.

#### Për të ndaluar dhe regjistruar

1. Lidhni diskun USB me një nga lidhjet **USB** në televizor. Mos lidhni pajisje tjetër USB në foletë e tjera USB gjatë formatimit.


2. Ndizni televizorin dhe diskun USB.

3. Kur televizori është i sintonizuar në një kanal televiziv dixhital, shtypni **II** (Pushim). Përpjekja për ta pushuar fillon formatimin.


Ndiqni udhëzimet në ekran.

Pasi të jetë formatuar, lëreni të lidhur diskun USB.

Për televizorë të serive 4503, 5503, 4304, 4354, 4504, 5304



Për televizorë të serive 5505, 5525, 5535



### Paralajmërim

Disku USB formatohet ekskluzivisht për këtë televizor dhe nuk mund t'i përdorni regjistrimet e ruajtura në një kompjuter apo televizor tjetër. Mos i kopjoni apo ndryshoni skedarët e regjistrimit në diskun USB me aplikacione kompjuterike. Kjo do t'i dëmtonte regjistrimet. Kur formatoni një disk tjetër USB, materialet në diskun e parë humbin. Disku USB i instaluar në televizor duhet të riformatohet për përdorim me kompjuter.

#### Shënim:

Funksioni i regjistrimit është vetëm për transmetimet televizive dixhitale. Nuk është e mundur të regjistrohen materiale nga pajisje të jashtme (p.sh. HDMI).

## 9.2

### Regjistrimi

#### Çfarë ju duhet

Mund të regjistroni një transmetim televiziv dixhital dhe ta shihni më vonë.

Për të regjistruar një program televiziv ju duhet...

- një njësi e lidhur disku USB e formatuar në këtë televizor
- kanalet dixhitale televizive të instaluar në këtë televizor
- për të marrë informacionin e kanaleve për guidën televizive në ekran
- një cilësim të besueshëm të orës së televizorit. Nëse e caktoni manualisht orën e televizorit, regjistrimet mund të mos kryhen.

Nuk mund të kryhet regjistrim gjatë përdorimit të funksionit "Pushimi i televizorit".

Për sa i përket zbatimit të legjislacionit të të drejtave të autorit, disa operatorë të DVB mund të vendosin kufizime të ndryshme me anë të teknologjisë DRM (menaxhimi i të drejtave dixhitale). Në rastin e transmetimit të kanaleve të mbrojtura, regjistrimi,

vlefshmëria e regjistrimit ose numri i shikimeve mund të kufizohen. Regjistrimi mund të ndalohej plotësisht. Mund të shfaqet një mesazh gabimi nëse përpigëni të regjistroni një transmetim të mbrojtur apo të rishikoni një regjistrim të skaduar.

---

## Regjistrimi i një programi

---

### Regjistrimi në moment

Për të regjistruar programin që jeni duke parë, shtypni **●** (Regjistro) në telekomandë. Regjistrimi fillon menjëherë.

Për të ndaluar regjistrimin, shtypni **■** (Ndalo).

Kur ofrohen të dhënat e "Guidës televizive", programi që po shikoni do të regjistrohet që nga momenti që shtypni tastin e regjistrimit deri në fund të programit. Nëse nuk ofrohen të dhëna për guidën televizive, do të regjistrohen vetëm 30 minutat e fundit të programit. Koha e përfundimit të regjistrimit mund të rregullohet në listën e Regjistrimeve.

---

### Planifikimi i një regjistrimi

Mund të planifikoni regjistrimin e një programi të ardhshëm që do të transmetohet sot ose pas disa ditësh (maksimumi pas 8 ditësh). Televizori do të përdorë të dhënat nga "Guida televizive" për të nisur dhe përfunduar regjistrimin.

Për të regjistruar një program...

1. Shtypni **☰** TV GUIDE.
2. Te guida televizive, zgjidhni kanalën dhe programin që dëshironi të regjistroni. Shtypni **➤** (Djathtas) ose **➤** (Majtas) për të lëvizur mes programeve të një kanali.
3. Me programin të theksuar, zgjidhni tastin me ngjyrë **●** Regjistro . Programi është programuar për t'u regjistruar. Do të shfaqet automatikisht një paralajmërim nëse planifikoni regjistrime të mbivendosura. Nëse programoni ta regjistroni programin në mungesën tuaj, kujtohuni ta lini televizorin në gjendje pritjeje dhe diskun USB të aktivizuar.

---

### Lista e regjistrimeve

Mund t'i shikoni dhe menaxhoni regjistrimet në listën e regjistrimeve. Përbri listës së regjistrimeve, ka një listë të veçuar për regjistrimet dhe rikujtuesit e planifikuar.

Për të hapur listën e regjistrimeve...

1. Shtypni **☰** TV GUIDE.
2. Shtypni tastin me ngjyrë **●** Regjistrimet .
3. Pasi të keni zgjedhur regjistrimin në listë, mund ta

hiqni me tastin me ngjyrë **●** Hiq . Një regjistrim mund ta rimehtëni me tastin me ngjyrë **●** Riemërto . Ose mund të shtypni tastin me ngjyrë **●** Rregullim i orarit për të ndryshuar orën e nisjes dhe të përfundimit të regjistrimit.

---

## Shikimi i një regjistrimi

Për të parë një regjistrim...

1. Shtypni **☰** TV GUIDE.
2. Shtypni tastin me ngjyrë **●** Regjistrimet .
3. Në listën e regjistrimeve, zgjidhni regjistrimin që ju nevojitet dhe shtypni **OK** për të filluar shikimin.
4. Mund të përdorni tastet **||** (pushim), **▶** (luajtje), **◀◀** (mbrapa), **▶▶** (shpejt përpara) ose **■** (ndalim).
5. Për t'u rikthyer në televizor, shtypni **TV** EXIT.

---

9.3

## Pushimi i televizorit

---

### Çfarë ju duhet

Teletransmetimin dixhital mund ta pushoni dhe ta rinisni pak më vonë.

Për të pushuar një program televiziv ju duhet...

- një njësi e lidhur disku USB e formatuar në këtë televizor
- kanalet dixhitale televizive të instaluar në këtë televizor
- për të marrë informacionin e kanaleve për guidën televizive në ekran

Me diskun USB të lidhur e të formatuar, televizori ruan vazhdimisht transmetimin televiziv që jeni duke parë. Kur kaloni në një kanal tjetër, transmetimi i kanalit të mëparshëm fshihet. Gjithashtu, kur e kaloni televizorin në gjendje pritjeje, transmetimi spastrohet.

Televizori nuk pushohet dot kur jeni duke regjistruar.

---

### Pushimi i programit

Për të pushuar dhe rifilluar transmetimin...

Për të pushuar transmetimin, shtypni butonin **||** (Pushim). Një shirit ecurie shfaqet shkurtimisht në fund të ekranit. Për të hapur shiritin e ecurisë, shtypni sërish **||** (Pause). Për të rifilluar shikimin, shtypni **▶** (Play).

Me shiritin e ecurisë në ekran, shtypni butonat **◀◀** (Mbrapa) ose **▶▶** (Përpara) për të zgjedhur ku dëshironi të filloni të shikoni transmetimin e pushuar. Për të ndryshuar shpejtësinë, shtypni këto

taste vazhdimisht.

Transmetimin mund ta pushoni për një periudhë maksimale prej 90 minutash.

Për t'u rikthyer në teletransmetimin e drejtpërdrejtë, shtypni ■ (Ndalim).

---

## Riluajtja

Meqenëse televizori ruan transmetimin që jeni duke parë, në shumicën e rasteve, transmetimi mund të luhet sërish për disa sekonda.

Për të riluajtur transmetimin aktual...



1. Shtypni || (Pushim)
2. Shtypni ◀◀ (Mbrapa). Mund të shtypni disa herë ◀◀ për të zgjedhur nga ku dëshironi të filloni shikimin e transmetimit të pushuar. Për të ndryshuar shpejtësinë, shtypini këto taste vazhdimisht. Në një moment do të kapni fillimin e memories së transmetimit ose intervalin kohor maksimal.
3. Shtypni ▶ (Luajtje) për ta parë sërish transmetimin.
